



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel: 0694057089

E-mail: rmuca@klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 30/06/2019

Bujar LESKAJ

KRYETAR




Raport Përfundimtar Auditimi Performance

“NDOTJA AKUSTIKE”



UNDERSTANDING NOISE LEVELS



Rinald Muça

Drejtor i Departamentit

Publik: Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", specifikisht nenin 34, pika "b", sikurse **promovimi i përmirësimeve në sektorin publik**, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti të bëhet referuar burimit të tij zyrtar: "Departamenti i Auditimit të Performancës – Kontrolli i Lartë i Shtetit"



Departamenti i Performancës në KLSH @ Performanca

QERSHOR 2019

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS "NDOTJA AKUSTIKE"

QESHOR 2019

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1431/8, datë 12.03.2019.

Faza studimore e auditimit nisi me shkresën për njoftim-fillim auditimi me nr. prot. 1431, 1431/1, 2, 3, 5, 6, 7 datë 28.12.2018 dhe nr. prot. 49, datë 17.01.2019 dhe përfundoi më datë 12.03.2019.

Faza e terrenit të auditimit nisi më datë 12.03.2017 me programin e auditimit cituar më lart dhe përfundoi më datë 27.03.2019.

Projekt-raporti i auditimit mori formë përfundimtare në datën 27.05.2019 dhe me shkresën nr. prot. 1431/9, 10,11 iu përcoll më datë 27.05.2019 subjekteve nën auditim:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
3. Bashkisë Tiranë;

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimi priti observacionet nga subjektet nën auditim. Instituti i Shëndetit Publik përcollti observacionet brenda afatit ligjor me shkresë nr. prot. 1/4, datë 17.06.2019, protokolluar në KLSH me nr. prot. 1431/12, datë 19.06.2019. Subjektet e tjera të këtij auditimi nuk dërguan observacione, duke pranuar në heshtje projekt-raportin auditues. Në rastet kur observacionet e dërguara nga subjekti në auditim janë marrë parasysh lidhur me gjetjet, konkluzionet apo rekomandimet e Projekt-Raportit, janë bërë ndryshimet përkatëse në Raportin e auditimit në reflektim të observacioneve përkatëse.

Raporti përfundimtar është hartuar nga:

1. Aulent Guri, Kryeauditues (Përgjegjës grupi)
2. Eva Kasmi, Aaudituese e parë (Anëtar)
3. Rejlond Sinanaj, Auditues i dytë, (Anëtar)

Procesi auditues u mbikëqyr nga drejtori i dept., z. Rinald Muça

PËRMBAJTJA

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT.....	6
1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL	6
1.2 STRATEGJIA E KLSH-SË NË AUDITIMET E PERFORMANCËS.....	9
1.3 AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË	9
1.4 SUBJEKTI NËN AUDITIM.....	10
1.4.1 Subjektet që do të përfshihen në auditim.....	10
1.4.2 Hyrje	11
1.4.3 Politikat e Institucionit/Agjencisë	14
1.4.4 Pesha në buxhet	15
1.4.5 Risqet e aktiviteteve të subjekteve	18
1.4.6 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	21
1.4.7 <i>Feedback</i> -u i subjektit në fazën studimore.....	22
2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT	23
2.1 Objektivi dhe problemi i performancës	23
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit	23
2.1.2 Objektivi i auditimit.....	24
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia	24
2.3 Kriteret.....	26
3.1.1 Kriteret politike	26
2.3.1 Kriteret teknike	26
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit.....	27
2.3.3 Kriteret e tjera.....	28
2.4 PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE	29
2.5 Qasja/metodologjia e auditimit	30
2.5.1 Metodatat/teknikat audituese.....	30
2.6 Rezultatet e parashikuara.....	30
2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë.....	30
2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit	31
2.6.3 Forma e publikimit.....	31
3. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	32
3.1 A kanë qenë efektive politikat dhe legjislacioni në fuqi për zgjidhjen e problemeve të ndotjes akustike?.....	32
3.1.1 A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qenë efektive ato?.....	32
3.1.2 A janë hartuar dhe zbatuar politika të përshtatshme nga Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore?.....	36
3.2 A ka patur impakt negativ ndotja akustike në shëndetin publik?	42
3.2.1 A kanë qenë efektive politikat e ndërmarra nga MSHMS për mbrojtjen e shëndetit publik nga zhurmat mjedisore?.....	42
3.2.2 A ka evidenca, raporte apo studime nga institucionet përkatëse mbi efektet negative të zhurmave në shëndetin publik?	44
3.3 A është funksional sistemi i monitorimit dhe inspektimit për zhurmat mjedisore?..	47
3.1.1 A është i besueshëm monitorimi i zhurmave nga AKM dhe ISHP?	47
3.3.2 A është efektiv sistemi i inspektimit për subjektet që gjenerojnë zhurmë?	54

3.3.3 A është efektiv sistemi i vetëmonitorimit të subjekteve private që gjenerojnë zhurma në mjedis?	56
3.3.4 A është trajnuar stafi i institucioneve përgjegjëse lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore?	57
4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	59
Aneksi I: PËRGJIGJET E PYETËSORIT “ON LINE” PËR PUBLIKUN LIDHUR ME ZHURMAT MJEDISORE	59
5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	65

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrulli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (International Standards of Supreme Audit Institutions)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
3E	Ekomiciteti, Efienca, Efektiviteti
dB	Decibel (Njësi matëse e zhurmës)
Lw	Niveli i fuqisë zanore
Leq	Niveli zanor ekuivalent
NIHL	Noise Induced Hearing Loss (<i>Humbje e detyruar e dëgjimit nga zhurmat</i>)
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISHMPUT	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
RGJM	Raporti i Gjendjes në Mjedis
PKMM	Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit
INSTAT	Instituti i Statistikave
NJVQV	Njësitë e Vetë-Qeverisjes Vendore
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
BT	Bashkia Tiranë
KTZH	Këshilli Teknik i Zhurmave
AMK	Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
EEA	European Environment Agency (<i>Agjencia Europiane e Mjedisit</i>)
YLL	Vitet e humbura të jetës (Year of life lost)
YLD	Vitet e jetuara me paaftësi (Year lived with disability)

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Misioni i KLSH – së në Strategjinë e Zhvillimit 2018 – 2022¹ kërkon që si *institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që t'i shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.*

Manaxhimi i suksesshëm i ndotjes akustike si një proces kompleks, duke balancuar çështjet konkurruese ekonomike, sociale dhe mjedisore, kërkon një qasje strategjike afatgjatë që përfshin veprime nga një gamë e gjerë e institucioneve, bizneseve dhe organizatave të tjera të qytetit.² Nisur nga fakti se banorët e qytetit të Tiranës prej vitesh ndodhen përballë një problemi tepër shqetësues siç është ndotja akustike, ku niveli i saj është tej normave të lejuara nga BE, Kontrolli i Lartë i Shtetit u orientua së fundmi drejt auditimit të ndotjes akustike duke marrë si rast studimor qytetin e Tiranës. Efektet e zhurmave në shëndet janë të ndryshme dhe për këtë shkak cilësohen si faktorë të rëndësishëm negativ në gjendjen fizike dhe mendore të shëndetit human. Duke iu referuar dhe thënies “shëndeti është një gjendje e të qenit mirë nga ana fizike, mendore, sociale dhe jo vetëm mungesë e sëmundjes ose pafuqisë” konsiderojmë për nga rëndësia si mjaft impaktive në identifikimin e problematikave të krijuara nga ky efekt.³ Referuar Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, problematika e ndotjes akustike është përgjegjësi e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucioneve të tyre të varësisë (respektivisht AKM, ISHMPUT dhe ISHP) si dhe Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore duke përzgjedhur Bashkinë e Tiranës.

Nëpërmjet këtij auditimi KLSH synon t'i ofrojë taksapaguesve një raportim të besueshëm, të pavarur dhe objektiv mbi efektivitetin e veprimtarisë së këtyre institucioneve duke e konsideruar zhvillimin e tij krahasuar me praktikën më të mira, si një prioritet thelbësor për mirëqenien e qytetarëve.

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Zhurma mjedisore përcaktohet si: “një tingull i jashtëm i padëshiruar dhe i dëmshëm i shkaktuar nga veprimtaritë njerëzore, duke përfshirë zhurmat e emetuara nga mjetet e transportit, trafiku rrugor, trafiku hekurudhor, trafiku ajror dhe nga veprimtaritë industriale në të cilat njerëzit janë të ekspozuar, në veçanti në zonat e banimit, në parqet

¹ Miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 31.12.2017 “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH- së për Periudhën 2018 – 2022”.

² Noise Strategy 2016-2026, London, UK, Department of Markets and Consumer Protection;

³ Vlerësimi i prevalencës së çrregullimeve të gjumit dhe bezdisjes së popullatës nga zhurmat e trafikut urban, në qytetet kryesore të Shqipërisë. ISHP. 2014

publike ose në zona të tjera të qeta të mbyllura, në zonat e qeta në vende të hapura, pranë shkollave, spitaleve dhe zonave e ndërtesave të tjera të ndjeshme nga zhurmat”⁴ Raportimet zyrtare të Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë konfirmojnë se ndotja akustike është kthyer në një problem për jetën e qytetarëve për shkak të pasojave që shkakton në shëndetin e tyre. Agjencia Evropiane e Mjedisit, në studimin e saj të fundit në nëntor të vitit 2018 konstaton se të paktën 43 mijë persona që kërkojnë ndihmë mjekësore preken drejtpërdrejt nga ndotja akustike, ndërsa 10 mijë të vdekur të parakohshëm lidhen me këtë problem. Numri i njerëzve që vuajnë nga shqetësimet për shkak të tejkalimit të normës së zhurmës, në Evropë arrin edhe deri në 20 milionë. Po ashtu, çdo vit shkaktohen mbi 900 mijë raste të hipertensionit për shkak të ndotjes akustike në Evropë.⁵

Zhurma e mjedisit, e shkaktuar nga trafiku, aktivitetet industriale dhe rekreative, konsiderohet të jetë një problem i rëndësishëm mjedisor lokal në Evropë. Sipas raportit të publikuar nga OBSH (2011), zhurma mjedisore çon në një barrë sëmundjeje që është e dyta në madhësi pas ndotjes së ajrit.⁶ Efektet në shëndet të ndotjes nga zhurma, janë të ndara sipas efekteve specifike: bezdisja, çrregullimet e gjumit, interferenca në komunikim, ulje të performancës, risk për sëmundjet kardiovaskulare, dëmtim të dëgjimit etj. Për një pjesë relativisht të vogël të popullatës këta faktorë mund të kalojnë në simptoma klinike si pagjumësi dhe sëmundje kardiovaskulare të cilat, si pasojë, mund edhe të rrisin shkallën e vdekshmërisë. Nivelet e larta të zhurmës mund të rezultojnë në efekte kardiovaskulare dhe ekspozimi, ndaj, gjatë një periudhe të vetme tetë-orëshe shkakton një rritje në presionin e gjakut prej pesë deri në dhjetë pikë, stres si dhe rritjen e probabilitetit së sëmundjes së arteries koronare.⁷ Zhurmat mund të përbëjnë kërcënime serioze për shëndetin fizik dhe psikologjik të fëmijëve, duke përfshirë sjelljen dhe aftësinë për të mësuar. Ekspozimi i përsëritur ndaj zhurmave gjatë periudhave kritike të zhvillimit krahas problemeve me dëgjimin mund të ndikojë në aftësinë e të folurit dhe të lexuarit të fëmijëve. Pamundësia për t'u përqëndruar në një mjedis të zhurmshëm mund të ndikojë në aftësinë e fëmijës për të mësuar. Te fëmijët të cilët janë të ekspozuar ndaj zhurmave të larta mund të shkaktohen sëmundje kardiovaskulare, presion i lartë i gjakut si dhe probleme të shumta me gjumin.⁸

Burimet e zhurmave në zonat urbane janë të shumta, por në këtë auditim u analizuan zhurmat e shkaktuara nga transporti rrugor, aktivitetet e shërbimit social që gjenerojnë zhurma nëpërmjet muzikës (bare, restorante, pabe, disko), ndërtimet si dhe makineritë dhe pajisjet e ndryshme në ambientet e jashtme. Nga të gjitha këto veprimtari, njerëzit janë të ekspozuar në veçanti në zonat e banimit, në parqet publike, pranë shkollave, spitaleve, zonave dhe ndërtesave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave. Shqipëria renditet në vendin e 23-të mes 98 vendeve të analizuara nga Numbeo për indeksin e ndotjes akustike. Indeksi i përgjithshëm i ndotjes për vitin 2018 rezultoi 75.21 dB, ndërkohë që indeksi i kombinuar i dy ekstremeve, pra shkallës më të lartë të ndotjes akustike dhe asaj më të ulët ka dhënë një rezultat prej 130.4 dB. Nga vendet e rajonit

⁴ WHO. 2000. Guidelines for community noise. Berglund B, Lindvall T, Schwela DH, editors. Geneva: World Health Organization.

⁵ Raporti i Gjendjes në Mjedis, AKM, 2017

⁶ Final Report ENNAH – European Network on Noise and Health 2013.


⁷ Road traffic noise and public health effects. University of Pittsburgh. 2015

⁸ United States Environmental Protection Agency, November 2009.

vetëm Maqedonia ka një ndotje akustike më të lartë, që e rendit atë në vendin e 12 ndërsa pjesa tjetër janë dukshëm më mirë sesa ne. Kjo është edhe një ndër arsyet kryesore nga ku KLSH mori iniciativën për të zhvilluar një auditim performance lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike nga institucionet përgjegjëse.⁹

Akoma sot ekzistojnë vështirësi në përcaktimin e efekteve negative shëndetësore që vijnë nga zhurmat. Kjo papërcaktueshmëri vështirëson mjaft analizën e domosdoshme të kostove të ndërhyrjeve për reduktim të ndotjes akustike në lidhje me të mirat apo përfitimet shëndetësore në tërësi që në fund përkthehen edhe në përfitime ekonomike. Psh, efekti kosto është i njohur: shembull mund të jetë degradimi i zonave të banuara shumë të ekspozuara ndaj zhurmave mjedisore. Zhurma sjell sëmundje, humbje të produktivitetit, dhe nivele të larta të aksidenteve të shkaktuara nga shqetësimet e gjumit, të cilat kanë kosto, por që është e vështirë të përcaktohet nga ana sasiore. Deklaratat zyrtare të Policisë së Tiranës të bëra për media në Gushtin e vitit 2018 raportojnë se çdo muaj mbërrijnë rreth 2000 ankesa nga qytetarët në lidhje me zhurmat që shkaktohen nga bizneset pranë banesave të tyre. Në disa prej zonave më të banuara në qytet, të cilat janë të tejmbushura me lavazho, furra buke, karburante, lokale, etj., zhurma e tyre shkakton shqetësim te banorët. Ndërkohë që në polici referohen 2000 ankesa në muaj vetëm për këtë çështje, masa për zgjidhjen e kësaj situatë nuk ka pasur dhe raportimet kanë vijuar nga muaji në muaj me të njëjtin intesitet nga qytetarët.¹⁰ Të dhënat zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, tregojnë se ndotja akustike urbane në kryeqytet arrin në vlerën e 70 dB ditën dhe 57dB natën, pra rreth 20 dB më e lartë se standardi i normave të Bashkimit Europian për nivelin kufi të ndotjes akustike. Vlerësimet mbi gjendjen e zhurmave për vitin 2018 pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm ku duket qartë që niveli mesatar është tej normave të lejuara.

Grafiku nr. 1: Pikat e monitorimit të zhurmave në Tiranë 2018



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit 2018

⁹<https://balkanweb.com/ndotja-akustike-shqipëria-e-23-a-mes-98-vendeve-një-projekt-kundër-borive/>

¹⁰ <http://shqiptarja.com/video/ndotja-akustike-në-tiranë-në-nivel-kritik-ja-zonat-më-të-prekura>

Figura e mëposhtme pasqyron nivelin e zhurmave të shkaktuar nga transportit rrugor ku matjet janë kryer gjatë ditës në vitin 2014 nga AKM.

Figura nr.1: Niveli i zhurmave nga trafiku rrugor



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit 2014

1.2 STRATEGJIA E KLSH-SË NË AUDITIMET E PERFORMANCËS

Sipas përkufizimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) auditimi i performancës është një “shqyrtim i pavarur i efikasitetit dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin”. Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga ekzekutivi dhe mund të kryhet në të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditimet standarde financiare apo të ligjshmërisë, pasi karakterizohet nga fleksibiliteti në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinionëve dhe rekomandimeve. Auditimi i performancës është një metodë moderne nëpërmjet të cilës taksapaguesit, financiarët, vendim-marrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi ushtrojnë kontroll mbi mënyrën e kryerjes së punës dhe arritjen e objektivave nga ana e enteteve shtetërore. Ky lloj auditimi nuk ka si synim parësor të kritikojë entet e mësipërme, por të arrijë korrektimet e duhura, përmirësimin e 3E-ve dhe rritjen e mirëqenies sociale përmes aktiviteteve publike.¹¹

1.3 AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË

Nga KLSH janë kryer në vitin 2015 dhe 2017, edhe pse jo i lidhur drejtpërdrejt me ndotjen akustike, dy auditime performace në fushën e mjedisit me temë:

¹¹ Shih Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës, Seria e Botimeve të KLSH, 2015.

- **“Cilësia e ajrit”**¹², për të cilin masat e marra nga qeverisja qendrore dhe lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vendin tonë nuk kanë qenë efektive dhe eficiente. Mesazhi kryesor i këtij auditimi ishte “Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit nuk është miratuar dhe si rrjedhojë asnjë Bashki në Shqipëri nuk ka miratuar Planet Vendore të Veprimit të Cilësisë së Ajrit. Monitorimi i cilësisë së ajrit nuk i përmbush plotësisht standardet e vendosura nga direktivat përkatëse të BE-së. Vlerat e publikuara për Tiranën, ashtu si edhe për qytetet e tjera të Shqipërisë nga stacioni i lëvizshëm i AKM-së nuk janë përfaqësuese si vlera mesatare të tyre. Numri i stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse. ISHMP nuk kryen inspektime sa i përket tejkalimit të normave të shkarkimeve të elementëve ndotës të ajrit”.
- **“Implementimi i Politikave Mjedisore”**¹³ në të cilin rezultoi se Ministria e Mjedisit megjithëse ka hartuar kuadrin legjislativ të përafuar me kërkesat e fushës të BE-së, nuk ka realizuar dhe nuk e ka plotësuar me aktet nënligjore përkatëse, kryesisht lidhur me Direktivat mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Krimin Mjedisor. Performanca e institucioneve dhe punonjësve përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ajrit është e ulët për shkak edhe të mungesës së fondeve, mospërputhjes së kërkesave të vendit të punës me përgatitjen profesionale të tyre si dhe nivelit të ulët të ndëgjegjes juridike për të dhënë zgjidhje ligjore problemeve mjedisore.

1.4 SUBJEKTI NËN AUDITIM

1.4.1 Subjektet që u përfshinë në auditim

Institucionet që janë përfshirë në këtë auditim janë:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me drejtorinë përkatëse: Drejtoria e Mjedisit dhe Jetësimin të Projekteve.

Institucionet në varësi të MTM të cilët kanë qenë gjithashtu pjesë e këtij auditimi janë si më poshtë:

- a) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- b) Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionin në varësi të saj:

- a) Instituti i Shëndetit Publik;

Bashkia e Tiranës:


Përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me zhvillimin e politikave, planeve për mbrojtjen e mjedisit urban, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së banorëve, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Tiranës dhe territoreve përreth.¹⁴

¹² Ky auditim u krye bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. 682/4, datë 06.10.2017 në MTM, AKM, ISHMPUT dhe ISHP.

¹³ Ky auditim u krye në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. 861/1, dt. 08.01.2015 në MTM, AKM, ISHMPUT; ARM-të e qarqeve Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier.

¹⁴ Rregullore për Organizimin, Funkionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Aparatit të Bashkisë së Tiranës, fq. 34, pika 36.5.

Skema nr. 1: Subjektet nën auditim



1.4.2 Hyrje

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e zhurmave në mjedis janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkia Tiranë si NJQV e përzgjedhur në auditimin tonë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin. MTM ushtron veprimtarinë e saj në sektorin e mjedisit, duke përfshirë politikat, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis.¹⁵ Dy institucionet e varësisë së MTM që kanë qënë objekt auditimi janë; Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

AKM është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky institucion është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit.¹⁶ ISHMPUT-ja ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve. ISHMPUT-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën përkatëse të mjedisit dhe pyjeve, në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për mjedisin.¹⁷ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin

¹⁵ Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Miratuar me Urdhrin nr. 420, datë 07/11/2018.

¹⁶ Rregullore e Brendshme Për Organizimin Dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit 2014.

¹⁷ Rregullore e Brendshme Nr. 2, Datë 18.07.2016 për Organizimin dhe Funkcionimin e Inspektoriatit Shtetëror Të Mjedisit dhe Pyjeve në Nivel Qëndror dhe Rajonal.

dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.¹⁸

Instituti i Shëndetit Publik si institucion varësie i MSHMS, konsiston në zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive e faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, dhe zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me agjenci apo organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.¹⁹

Bashkia e Tiranës është përgjegjëse për mirë-administrimin e çdo çështje që lidhet me zhvillimin e politikave, planeve për mbrojtjen e mjedisit urban, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së banorëve, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Tiranës dhe territoreve përreth.²⁰

Në Progres-Raportin e BE-së të Nëntorit 2016, në Kapitullin 27, “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, theksohet se: *Përafrimi me “acquis” për zhurmën e mjedisit është në një fazë të hershme. Standardet e nivelit të zhurmës për përdorim në mjedis të pajisjeve edhe pse janë miratuar, aktet nënligjore ende mungojnë dhe kapaciteti zbatues është i dobët. Shkeljet e kufijve të zhurmës janë të pranishme në disa qytete të Shqipërisë. Zhurma nuk mbulohet nga planifikimi hapësinor. Nuk ka programe dhe statistika specifike për efektet shëndetësore të zhurmës. Raportimi mbi zbatimin e planit kombëtar të zhurmës nuk ka patur asnjë progres.*²¹ Ndërsa në Progres-Raportin e BE-së së 2018 për Shqipërinë theksohet se: *Kapaciteti administrativ për përgatitjen e hartave strategjike të zhurmave dhe planeve të veprimit duhet fuqizuar.* Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar nivelet kufi të zhurmës për mjedise të caktuara, sipas vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

Tab. 1 NIVELET KUFIT TË ZHURMËS PËR MJEDISE TË CAKTUARA

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	L _{Amax} Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-

¹⁸ <https://shendetesia.gov.al/misioni-2/>

¹⁹ <http://www.ishp.gov.al/misioni-i-ishp/>

²⁰ Rregullore e Bashkisë Tiranë me VKB nr. 25661, datë 02.07.2018 për “Një Ndryshim të Rregullores për Organizimin, Funkionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Aparatit të Bashkisë së Tiranës”

²¹ Progres Raporti i BE-së për Shqipërinë, 2016, faqe 80

Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlëra nga jashtë)	45	8	-
Institucione				
Klasa mësimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmëri e bisedës, vështirësi në kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjatë mësimi	-
Dhomat e fjetjes në kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri i shkollës, vendet e lojrave në shkollë	Bezdi (shqetësim) - (burime të jashtëme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit natën	30	8	40
	Prishja e gjumit ditën dhe në mbrëmje	30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim në pushim, çlodhje	# 1		
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët □ 5 herë/ vit)	100	4	110
Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85 # 4	1	110
Tinguj - zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit) Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140#2 120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

Shpjegime:

LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

LAmaz Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën fast (e shpejtë)

1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.

2 = Presioni zanor maksimal (LAmaz, fast) matur 100 mm larg veshit.

3 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.

4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë.

Burimi: Udhëzim nr. 8, datë 27.11.2007, "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara", Aneksi 1

1.4.3 Politikat e Institucionit/Agjencisë

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (MTM) është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për manaxhimin e ndotjes akustike. Objektivat e këtij institucioni synojnë në manaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave me qëllim respektimin e niveleve të lejuara, hartimi i planit kombëtar të veprimit për manaxhimin e zhurmave, marrjen e masave për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor. Gjithashtu MTM organizon ngritjen e Grupeve të Punës dhe Task Forcave për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis. Drejtoria e Mjedisit dhe Jetësimit të Prioriteteve (DMJP) është struktura përgjegjëse për manaxhimin e ndotjes akustike e cila ka për detyrë: hartimin dhe ndjekjen e politikave dhe programeve lidhur me evidentimin dhe reduktimin e ndotjes akustike.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit²² ka si objektiva kryesorë hartimin e Raportit Vjetor të Gjendjes në Mjedis, bashkëpunimet ndërinstucionale për grumbullimin e informacioneve që kanë të bëjnë me tregues të caktuar mjedisorë, si dhe mirëmbajtjen dhe zhvilloimin e laboratorit për kryerjen e analizave mjedisore. Ndër të tjera, ajo vlerëson natyrën, shkallën dhe rëndësinë e dëmeve të shkaktuara në mjedis, rrezikun ndaj shëndetit të njeriut dhe aftësinë e rehabilitimit natyror. AKM është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve që jep në lejet përkatëse të mjedisit, manaxhon dosjet e subjekteve të cilët dërgojnë të dhëna për vetëmonitorimin në përputhje me lejet përkatëse të mjedisit që zotërojnë dhe bashkëpunon me Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe me organizata të tjera ndërkombëtare mjedisore.

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujerave dhe Turizmit²³ ISHMPUT ka në kompetencë të tij hartimin e raporteve periodike të indikatorëve të inspektimit të cilat i dergohen strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit. Siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore sipas parimit “Ndotësi paguan” dhe angazhohet në vendosjen e dënimeve administrative për shmangien e rreziqeve që mund ti shkaktohen interesit publik në bazë të legjislacionit në fuqi. Inspektoriati, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret, duke vlerësuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

Instituti i Shëndetit Publik është një institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrit të Shëndetësisë, krijuar me ligjin nr. 10 138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik” si një qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni. ISHP ushtron veprimtarinë e tij në fushat e mbikëqyrjes epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe jo infektive; manaxhimit të regjistrave kombëtarë, kërkimit shkencor në

²² AKM është krijuar si ristrukturim i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve në mbështetje të ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” dhe VKM-së nr. 47, datë 29.01.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit.

²³ ISHMPUT është krijuar me VKM nr. 46 datë 29.01.2014 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të InsISHMPUT” i ndryshuar, si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin.

shëndetin publik; ndjekjes së të rejave shëndetësore ndërkombëtare, përfshirë sistemet dhe praktikën, trajnimin dhe edukimin universitar në shëndetin publik; informimin e popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik. Më specifikisht në lidhje me ndotjen akustike ky institucion ka si objekt vlerësimin natyror, shkallën dhe rëndësinë e dëmeve të shkaktuara ndaj shëndetit të njeriut në zonat urbane nga ndotja akustike, organizon dhe kryen ekspertiza sanitare për vlerësimin e ndotjes akustike dhe elementeve të tjera të fizikës sanitare dhe shqyrton ankesat e ardhura për ndotësit e zhurmave si dhe kryen ekspertizën përkatëse.

Bashkia Tiranë nëpërmjet Drejtorisë së Politikave dhe Edukimit Mjedisor është përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me zhvillimin e politikave, planeve për mbrojtjen e mjedisit urban, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së banorëve, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Tiranës dhe territoreve përreth. Ajo adapton politikën kombëtare për mbrojtjen e mjedisit në nivelin e Bashkisë së Tiranës duke përcaktuar objektivat e zhvillimit dhe indikatorët për matjen e realizimit të tyre në nivel lokal. Bashkia Tiranë, përmes DPEM është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi, programet, veprimtaritë dhe proceset që manaxhohen prej saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës²⁴. Bashkia Tiranë referuar ligjit të zhurmave²⁵, ka detyrimin e përgatitjes dhe miratimit të :

- Planit vendor të veprimit për zhurmën;
- Procesit e hartëzimit të zhurmës.
- Shpalljes së zonave të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosjen e kufizimeve të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.

1.4.4 Pësja në buxhet

Për vitin 2016, buxheti faktik i **Ministrit e Turizmit dhe Mjedisit** ka qenë i ndarë në 3 programe buxhetore, e konkretisht: planifikimi, manaxhimi dhe administrimi, programe për mbrojtjen e mjedisit, administrimi i pyjeve me një total në 000/lekë prej 3.375.130. Për këtë vit, planifikimi, manaxhimi dhe administrimi përbëjnë 5% të buxhetit faktik total të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2016, mbrojtja e mjedisit 70%, administrimi i pyjeve 24%. Për vitin 2017, planifikimi, manaxhimi dhe administrimi përbën 4% të buxhetit faktik total, mbrojtja e mjedisit 72% të tij. Ndërsa buxheti faktik për administrimin e pyjeve është 23%. Totali i buxhetit për këtë vit është 3.430.800.000 lekë. Për vitin 2018 në MTM pjesë e strukturës është bërë edhe sektori mbi turizmin me VKM nr. 165, datë 05.10.2017 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” dhe kjo ka sjellë një rëndim të këtij sektori në buxhetin total të ministrisë.

²⁴ Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës, fq 34.

²⁵ Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 8, pikat 1, 2 dhe 3.


Tab. 2: Shpenzimet buxhetore të MTM për vitet 2016-2018 në 000/lekë

Nr.	Programet buxhetore	2016	%Tot	2017	%Tot	2018	%Tot
1	Planifikim dhe administrim	177.300	5%	151.400	4%	155.360	7%
2	Programe per mbrojtjen e mjedisit	2.377.078	70%	2.486.803	72%	994.883	44%
3	Administrimi i pyjeve	820.752	24%	792.597	23%	793.517	35%
4	Zhvillimi i turizmit	0	0%	0	0%	315.000	14%
	Totali	3.375.130	100%	3.430.800	100%	2.258.760	100%

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Nga tabela shohim se buxheti faktik për vitin 2018 është 34% më i ulët se viti i mëparshëm, edhe pse në organikën e tij është shtuar një sektor mjaft i rëndësishëm për vendin, siç është ai i turizmit. Programi për mbrojtjen e mjedisit në vitin 2018 është ulur me 60% krahasuar me vitin 2017, kjo si rrjedhojë e një buxheti total më të ulët dhe shtimit të sektorit të turizmit.

Grafik 2: Shpenzimet buxhetore të MTM-së, 2016-2018



2. Buxheti faktik i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit përbëhet nga paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, shpenzime operative, transferta korrente dhe investime për projekte. Nga tabela e mëposhtme vërehet se për periudhën objekt auditimi pesha më e madhe në totalin e shpenzimeve buxhetore zihet nga artikulli 601 për pagat e punonjësve. Shpenzimet operative, ku përfshihen shpenzimet e monitorimeve, në vitet 2017 dhe 2018 janë rreth 60% më pak se viti 2016. Ky institucion për vitin 2018 nuk ka kryer asnjë shpenzim për investime apo projekte. Sa i takon shpenzimeve që lidhen direkt për monitorimin e zhurmave në vitin 2018 janë më të larta se dy vitet e mëparshme por ato nuk kanë mundur kryerjen e monitorimeve në qytetin e Tiranës me shumë se një herë në vit. Këto shpenzime kanë shërbyer për rritjen e numrit të


pikave të monitorimit të zhurmave (për të gjithë Shqipërinë) dhe repektivisht 37 pika për vitin 2016, 43 pika për 2017 dhe 57 pika për 2018.²⁶

Tab. 3: Shpenzimet buxhetore të AKM-së në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i zërave të buxhetit	2016	%Tot	2017	%Tot	2018	%Tot
1	Pagat "600"	35,389	48%	42,076	63%	40,837	64%
2	Sigurimet "601"	5,740	8%	7,017	11%	6,473	10%
3	Shpenzimet operative "602"	26,254	35%	9,463	14%	9,932	16%
4	Shpenzimet operative lidhur direkt per zhurmat	1,587	2%	1,315	2%	2,414	4%
5	Transferimet korrente të brendshme "604"	5,020	7%	5865	9%	6108	10%
6	Transerta per ndihmë ekonomike "606"	-	0%	87	0%	60	0%
7	Investimet "231"	2,034	3%	1,801	3%	0	0%
	Totali	74,437	100%	66,309	100%	63,410	100%

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Grafik 3: Shpenzimet buxhetore të AKM-së, 2016-2018



3. Buxheti faktik i ISHP-së përbëhet nga paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, shpenzime operative, transferta korrente të huaja dhe investime për projekte. Nga tabela e mëposhtme vërehet se për periudhën objekt auditimi pesha më e madhe në totalin e shpenzimeve buxhetore zihet nga artikulli 605 transferta korrente të huaja. Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore nuk kanë pësuar luhatje të rëndësishme në vlerë, ndërsa shpenzimet për investime në të tre vitet kanë një vlerë thuajse të papërfillshme krahasuar me buxhetin total të ISHP-së. Sa i takon shpenzimeve për sektorin përgjegjës për zhurmat ato përbëhen nga shpenzime për paga dhe dieta për 5 punonjës si në tabelën 4 në pikën 6.


²⁶ Numri i pikave të monitorimit për vitet 2016, 2017 dhe 2018 është respektivisht sipas RGJM 2016 fq. 98, RGJM 2017 fq. 14 dhe PKMM 2018 fq. 28. Për vitin 2018 është marrë në konsideratë PKMM e 2018 pasi RGJM e 2018 akoma nuk është publikuar nga AKM.

Tab. 4: Shpenzimet buxhetore të ISHP për vitet 2016-2018

Nr.	Emërtimi i zërave të buxhetit	2016	%Tot	2017	%Tot	2018	%Tot
1	Pagat "600"	148,392,929	25%	160,164,633	30%	158,157,411	26%
2	Sigurimet "601"	24,559,561	4%	26,324,319	5%	26,074,980	4%
3	Shpenzimet operative "602"	86,113,729	15%	96,898,738	18%	113,396,783	19%
4	Transferimet korrente jashtë "605"	332,295,077	56%	239,992,597	46%	302,741,597	50%
5	Investimet "231"	372,000	0%	1,854,600	0%	-	0%
6	Shpenzimet për sektorin e Fizikës Sanitare	4,466,311	0.7%	4,357,216	0.8%	4,816,317	0.8%
	Totali	591,733,296	100%	525,234,887	100%	600,370,770	100%

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

Grafik 4: Shpenzimet buxhetore të ISHP-së, 2016-2018



Grafiku i mësipërm ilustron ndryshimet e shpenzimeve buxhetore për secilin artikull për periudhën objekt auditimi.

1.4.5 Risqet e aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, pra MTM, MSHMS dhe Bashkia Tiranë kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që institucionet hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, ato lidhen kryesisht me risqe të jashtme dhe të brendshme. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në Udhëzuesin e Vlerësimit të Riskut të Gjykatës Evropiane të

Llogarive.²⁷ Në tabelën në vijim janë grupuar risqet sipas nivelit strategjik dhe operacional. Janë marrë në konsideratë vetëm risqet e nivelit mesatar dhe të lartë, si dhe është analizuar niveli i vështirësisë që hasin subjektet në tejkalimin e këtyre risqeve. Për të përcaktuar nivelin e riskut, grupi i auditimit është bazuar në PKVZH të 2011, në Raportet e Gjendjes në Mjedis të 2016 dhe 2017, rregulloret e brendshme të institucioneve subjekt auditimi të cilat jo gjithmonë janë të sinkronizuara me aktet ligjore/nënligjore dhe evidentimin paraprak të mangësive logjistike të këtyre institucioneve. Në funksion të përmbushjes së kësaj kornize, është lidhur secili risk me pyetjet audituese që drejtojnë këtë program auditimi.

²⁷https://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/GUIDELINE_RISK_102013/GUIDELINE_RISK_102013_EN.pdf, fq. 15

Tabela. 5: Analiza e Riskut

Op / Str	Përshkrimi i Riskut	Niveli i Riskut	Pyetja e Auditimit	Realizueshmëria
Strategjik	Mungesa e Planeve Vendore të Veprimit, hartëzimit të zhurmave nga NJVQV.	L	A janë hartuar dhe zbatuar politika të përshtatshme nga Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore?	Vështirë Politikat e hartuara nga Bashkia Tiranë janë të nevojshme për një organizim dhe manaxhim më të mirë të ndotjes akustike në zonat urbane.
	Mungesa e studimeve mbi efekteve negative shëndetësore si pasojë e zhurmave mjedisore	L	A ka evidenca, raporte apo studime nga institucionet përkatëse mbi efektet negative të zhurmave në shëndetin publik?	Vështirë Realizimi i studimeve epidemiologjike në lidhje me zhurmat sjellin të dhëna mbi efektet shëndetësore si sëmundje kardiovaskulare, shëndetin e fëmijëve, tregues biologjikë, sëmundje respiratore, shëndeti mendor dhe gjumi. ²⁸ Vlerësimi i incidencave dhe prevalencave të humbjeve të detyruara të dëgjimit nga zhurmat (NIHL) mund të realizohet duke kombinuar raportin e njerëzve të ekspozuar nga zhurmat, riskun relativ të zhvillimit të NIHL për nivele të ndryshme ekspozimi, prevalencën dhe incidencën e NIHL brenda një shteti. ²⁹
	Mungesë e akteve nënligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis".	M	A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qënë efektive ato?	Normale Aktet nënligjore lidhur me zhurmat mjedisore pasi hartohen nga administrata e Ministrive përgjegjëse, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
Operacional	Mos zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore të manaxhimit të zhurmave mjedisore	M	A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qënë efektive ato?	Normale Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore është e rëndësishme sa i përket mborjtjes së shëndetit dhe të mjedisit duke përcaktuar mënyrën e shmangies, parandalimit dhe reduktimit të efekteve të dëmshme që sjellin zhurmat në mjedis.
	Nuk ka një përshkrim të saktë të metodologjisë së ndjekur për monitorimin e zhurmave mjedisore.	L	A është i besueshëm monitorimi i zhurmave nga AKM dhe ISHP?	Vështirë Kryerja e metodikave të standardizuara, sjellin rezultate monitorimi të besueshme dhe efektive për nivelin e zhurmave dhe impaktin që ato kanë në shëndetin publik.
	Mungesa e logjistikës(laboratorët) së duhur për kontrollin e subjekteve që gjenerojnë zhurmë.	L	A është efektiv sistemi i inspektimit për subjektet që gjenerojnë zhurmë?	Vështirë Kërkohet një sistem më efektiv për ndjekjen penale të mos zbatimit të legjislacionit, duke përfshirë një legjislacion të ri, që parashikon kundërvajtje specifike, me sanksione proporcionale dhe ndjekje e përshtatshme penale.
	Mungesa e një sektori të veçantë për zhurmat në MTM dhe MSHMS si dy institucionet përgjegjëse në hartimin e politikave të manaxhimit të zhurmave në mjedis.	M	A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qënë efektive ato?	Normale Mungesa e strukturës specifike për zhurmat në MTM dhe MSHMS sjell vështirësi në analizimin e efekteve negative të zhurmave në shëndetin publik.
	Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet MSHMS, MTM dhe BT për të hartuar kritere dhe standarde për zvogëlimin e zhurmave që në projektimin e ndërtimeve të reja.	L	A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qënë efektive ato?	Vështirë Kontrolli i zhurmave nga ndërtimet e reja është i vështirë të kryhet nga institucionet përkatëse përgjegjëse, për shkak se mungojnë standardet dhe kriteret ku të orientohet sektori i ndërtimeve.

²⁸ Final Report ENNAH – European Network on Noise and Health, page 68

²⁹ Noise Induced Hearing Loss: Epidemiology and Noise Exposure, 2011, page 23

1.4.6 Rëndësia e produkteve të subjektit

Produktet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit janë të lidhura ngushtësisht me përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, hartimin dhe ndjekjen e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Më konkretisht MTM ka përgatitur:

- Planin Kombëtar të Veprimit për Manaxhimin e Zhurmave në Mjedis i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.123, datë 17.2.2011;
- Udhëzimin nr. 8 datë 27.12.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”;
- Udhëzimin nr.5 datë 26.11.2010, “Për kriteret dhe procedurat për pajisje me Leje të Thjeshtë Mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”;
- Udhëzimin nr. 1 të Ministrit të MTM datë 07.01.2012 “Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave”;
- Vendim nr. 587, datë 07.07.2010, “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”;
- Urdhër i Përbashkët me nr. 58. datë 22.12.2017, “Për ngritjen e Grupit të Punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis”³⁰;
- Udhëzim nr. 1037/1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe manaxhimin e Zhurmës Mjedisore”.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit për periudhën objekt auditimi (2016-2018) ka përgatitur:

- Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2016;
- Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2017;
- Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2018;
- Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2016;
- Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2017.

Raportet e Gjendjes së Mjedisit publikohen në faqen zyrtare të AKM-së dhe hartohen në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Monitorimi dhe raportimi i zhurmave mjedisore zë një kapitull të veçantë si në PKMM ashtu edhe në RGJM. Raporti i Gjendjes së Mjedisit për vitin 2018 është duke u përgatitur dhe do të publikohet në gjysmën e dytë të vitit 2019. Funksione të tjera që AKM kryen janë pjesëmarrja në konferenca e kërkime të tjera shkencore që lidhen me mjedisin dhe zhvillimin e teknologjisë, manaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor si dhe bashkëpunimi me Agjencinë Evropiane të Mjedisit për të plotësuar detyrimet raportuese përkatëse.

Kontrolli i zbatimit të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis dhe akteve nënligjore të dala prej tij kryhet nga ISHMPUT. Ky inspektoriat ka përgatitur:

- Programin vjetor të inspektimit 2016;
- Programin vjetor të inspektimit 2017;
- Programin vjetor të inspektimit 2018;
- Raportin vjetor të inspektimit 2017;

³⁰ Ky Udhëzim, së bashku me Udhëzimin nr. 8 datë 27.12.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” janë përgatitur dhe miratuar nga MTM në bashkëpunim me MSHMS.

- Raportin vjetor të inspektimit 2018;

Gjithashtu, ISHMPUT është organi kompetent në vendosjen e masave administrative ndaj kundravajtësve që nuk respektojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Instituti i Shëndetit Publik, nëpërmjet Departamentit të Shëndetit dhe Mjedisit, (Sektorit të Fizikës Sanitare) është qendër reference kombëtare për çështjet e lidhura midis ndotjes akustike dhe shëndetit publik. Ekspertiza në fushën e ndotjes akustike, përmes monitorimit të vazhdueshëm si dhe ndërmarrjes së studimeve të thelluara shkencore, është një nga detyrimet kryesore të aktivitetit të Departamentit të Shëndetit dhe Mjedisit në ISHP.

Parimi i efektivitetit ose i thënë me fjalë më të thjeshta realizimi i objektivave të subjekteve të sipërpërmendura ka qënë baza kryesore mbi të cilin ky auditim është fokusuar. Mbrojtja e mjedisit në tërësi dhe e shëndetit publik në veçanti nga ndotja dhe dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë duke garantuar:

- Të drejtën e çdo individit për të jetuar në një mjedis të qetë dhe të shëndetshëm;
- Parandalimin ose uljen e pasojave të dëmshme mbi shëndetin publik;
- Vlerësimin e zhurmave në mjedis në bazë të metodave e të kriterëve që përdoren në komunitetin evropian;
- Marrjen e informacionit të përshtatshëm për zhurmat e gjeneruara në mjedis dhe për sigurimin e disponueshmërisë së këtij informacioni për publikun.

1.4.7 Feedback-u i subjektit

Sa i përket bashkëpunimit të subjekteve nën auditim me grupin e auditimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm ka rezultuar si më poshtë:

- ✓ Subjekti MTM me të dy institucionet e saj të varësisë (AKM, ISHMPUT) janë treguar bashkëpunues dhe i janë përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi grupit të auditimit.
- ✓ Subjekti MSHMS është treguar bashkëpunues dhe i është përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi grupit të auditimit.
- ✓ Subjekti ISHP, ka qënë bashkëpunues duke siguruar në kohë dhe me përpikmëri të gjitha materialet e kërkuara nga grupi i auditimit.
- ✓ Subjekti Bashkia Tiranë i është përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi të gjithë informacionit të kërkuar duke vënë në dispozicion të gjithë strukturën e tij.

2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT

2.1 Objektivi dhe problemi i performancës


Auditimi me temë “Ndotja Akustike” synon të informojë publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë mbi efektivitetin e veprimitarisë së institucioneve përgjegjëse për manaxhimin e procesit të minimizimit të zhurmave në qytetin e Tiranës, duke marrë në analizë se si këto institucione të ngarkuara me përgjegjësinë ligjore politikëbërëse dhe administrative kanë vepruar me synimin që të garantojnë komunitetin taksapagues, të ketë mundësi të jetojë dhe të punojë në ambiente ku garantohet cilësia e shëndetit të qytetarëve dhe zbatohen normat e lejuara të standardeve të çertifikuara ndërkombëtare për ndotjen akustike. Në këtë mënyrë kemi konkluduar se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi.

2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit

Në këtë auditim jemi përqëndruar në analizimin e efektivitetit të veprimitarisë së institucioneve përgjegjëse për manaxhimin e ndotjes akustike në qytetin e Tiranës, si qendra me popullsinë më të lartë në vendin tonë, për periudhën 2016-2018. Nisur nga impakti i madh që ka në shëndetin e njeriut, ndotja akustike, përbën një nga problemet më të mëdha sociale në qytetet kryesore të vendit tonë. Fokusimi i auditimit krahas zbatimit të politikave qeveritare në mbrojtje të zhurmave në mjedis sipas standardeve të BE-së, ka qenë përshkrimi i situatës aktuale, vlerësimi i monitorimit dhe inspektimit, si dhe evidentimi i studimeve apo projekteve të realizuara nga institucionet përgjegjëse. Bazuar në Planin Kombëtar të Veprimit të manaxhimit të zhurmave në mjedis, sektorët kryesor për gjenerimin e zhurmave janë:

1. Transporti (rrugor, ajror, hekurudhor);
2. Aktivitete të shërbimit social (klubet e natës dhe diskot, baret, restorantet);
3. Pajisje dhe makineritë (përpunim metali, prerje metalesh, sharrat, gjeneratorë, elektromotorë, kompresorë, çekiçë pneumatikë etj.).³¹

Skema nr. 2: Procesi i pajisjes me leje mjedisore për subjektet që gjenerojnë zhurma:




Burimi: Grupi i auditimit

³¹ Plani Kombëtar i Veprimit për manaxhimin e zhurmave në mjedis, 2011, fq 4;

Në këtë auditim jemi fokusuar kryesisht në pikën e dytë dhe pak në pikën e parë për sa i takon transportit rrugor në Bashkinë e Tiranës.

Gjithashtu është analizuar puna e kryer e çdo sektori pranë subjekteve nën auditim, përgjegjëse për politikëbërjen dhe manaxhimin e ndotjes akustike. Për këto arsye, grupi i auditimit ka vijuar auditimin në terren duke vizituar institucionet përgjegjëse si dhe duke monitoruar nga afër procesin e kryerjes së detyrave, për të parë se sa efektive ka qenë performanca e këtyre institucioneve duke i krahasuar me praktika të mira.

Skema nr. 3: Procesi i kryerjes së monitorimit të zhurmave dhe raportimit të tyre në RGJM nga AKM:



Burimi: Grupi i auditimit

2.1.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Ndotja akustike” është shtrirë në periudhën **2016–2018** dhe ka analizuar efektivitetin e institucioneve subjekt auditimi të cilat janë përgjegjëse për manaxhimin e zhurmave në mjedis dhe problematikave të dala prej tyre. Ky auditim ka për qëllim të ofrojë një tablo të qartë mbi situatën legjislative në vendin tonë, përafrimin me BE-në dhe gjendjen reale të ndotjes akustike në Shqipëri, duke analizuar masat e marra nga institucionet që kanë për detyrë kontrollin, monitorimin, raportimin e zhurmave dhe studimet e ISHP-së. Kushtet të cilat janë të nevojshme për të siguruar efektivitetin kanë të bëjnë me nivelin e performancës së subjekteve nën auditim.

2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

- "Zhurmë mjedisore" është çdo tingull, i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore, përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale, të cilat janë objekt i këtij ligji.
- "Efekte të dëmshme" janë efektet negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis.
- "Epidemiologji" është studimi i përhapjes dhe i shkaqeve të problemeve shëndetësore në një popullatë të caktuar.

- "Shëndet publik" është tërësia e përpjekjeve të organizuara të shoqërisë për zgjatjen e jetës, parandalimin e sëmundjeve dhe promovimin e shëndetit të të gjithë popullsisë.
- "Mbikëqyrja epidemiologjike e shëndetit publik" është një grumbullim sistematik, analizë, interpretim dhe shpërndarje e të dhënave shëndetësore në mënyrë të vazhdueshme, për të fituar njohuri për tablonë e shfaqjes dhe të potencialit të sëmundjes, në një popullatë të caktuar, për të kontrolluar dhe parandaluar sëmundjen.
- "Barrë e sëmundjes" janë shpenzimet shëndetësore dhe social-ekonomike, që rrjedhin nga një gjendje e caktuar shëndetësore apo një sëmundje.
- "Tregues shëndetësor" është një karakteristikë e një individi, popullate ose mjedisi, që matet (drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë) dhe mund të përdoret për të përshkruar një ose më shumë aspekte të shëndetit të një individi a popullsie (cilësinë, sasinë dhe kohën).
- "Sistemi i informacionit shëndetësor" është një kombinim i statistikave shëndetësore, nga burime të ndryshme, që përdoret për të nxjerrë të dhëna për gjendjen shëndetësore, kujdesin shëndetësor, ofrimin e përdorimin e shërbimeve shëndetësore dhe ndikimin në shëndet.
- "Bezdi nga zhurma" është shkalla e shqetësimit të komunitetit nga zhurma, e përcaktuar me mënyrën e vrojtimit në terren.
- "Burim zhurme" është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, aparat elektroakustik, që lëshon zhurmë, njësitë e objekteve të lëvizshme ose të palëvizshme dhe veprimtaritë sportive dhe argëtuese.
- "Nivel baze" ose "fon" është niveli i zhurmës mjedisore, kur burimi i zhurmës që matet nuk punon.
- "Indikator i zhurmës" është madhësia fizike, e përdorur për të përshkruar zhurmën mjedisore, që ka lidhje me një efekt të dëmshëm.
- "Leje mjedisi" është dokumenti zyrtar që lëshohet nga autoriteti mjedisor për veprimtari ekonomike e shoqërore, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në mjedis, sipas kërkesave të legjislacionit për mjedisin.
- "Vlerësim" është mënyra e përdorur, për të llogaritur, parashikuar, vlerësuar apo matur vlerën e indikatorit të zhurmës ose efektet e dëmshme që lidhen me të.
- "Marrëdhënie dozë-efekt" është marrëdhënia ndërmjet nivelit të zhurmës dhe një efekti të dëmshëm.
- "Zonë e banuar" është pjesa e një territori, me numër dhe dendësi popullsie, që e përcakton atë si një zonë urbane.
- "Zonë e qetë në një zonë të banuar" është një zonë, e përcaktuar dhe e kufizuar nga organet e pushtetit vendor, e cila nuk ekspozohet ndaj një zhurme me vlerë më të lartë se një vlerë kufi.
- "Zonë e qetë në një vend të hapur në natyrë" është një zonë, e përcaktuar dhe e kufizuar nga ministria, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, që nuk ekspozohet nga zhurma prej trafikut, industrisë ose veprimtarive të tjera.
- "Hartëzim i zhurmës" është paraqitja me indikatorë e të dhënave për zhurmën, për një gjendje ekzistuese ose të parashikuar, që tregon kapërcimin e nivelit kufi, numrin e njerëzve të ndikuar në një zonë të caktuar ose numrin e banesave të ekspozuara ndaj disa vlerave të indikatorit të zhurmës në atë zonë.

- "Hartë strategjike e zhurmës" është një hartë, që krijohet për vlerësimin global të ekspozimit ndaj zhurmës në një zonë të dhënë, nga burime të ndryshme zhurme ose për parashikimet e përgjithshme për një zonë të tillë.
- "Nivel kufi" është një vlerë e indikatorit të zhurmës, kapërcimi i së cilës e detyron organin përgjegjës të shqyrtojë situatën dhe të kërkojë marrjen e masave zbutëse. Niveli kufi është i ndryshëm për:
 - burime të ndryshme të zhurmës (zhurma të trafikut rrugor, hekurudhor, ajror, industrial);
 - mjedise të ndryshme;
 - popullata të ndryshme, me ndjeshmëri të ndryshme ndaj zhurmës;
 - situata të ndryshme, ekzistuese apo të reja, ku ndryshimi ka të bëjë me burimin e zhurmës ose me destinacionin e mjedisit rrethues.
- "Plan veprimi" është dokumenti i hartuar, për të manaxhuar problemet dhe pasojat e zhurmës, përfshirë pakësimin e saj deri në nivelin kufi.
- "Planifikim akustik" është kontrollimi i zhurmës, në të ardhmen, përmes masave të planifikuara si: planifikimi i përdorimit të tokës, sistemet inxhinierike për trafikun, planifikimi i trafikut, zbutja e zhurmës, përmes izolimit akustik dhe kontrolli i zhurmës që në burim;
- "Incidenca" është shkalla e rasteve të reja të diagnostikuara të sëmundjes.
- "Prevalenca" është numri aktual i rasteve të sëmundjeve.
- "Decibel" njësia e matjes së intesitetit të zhurmës.

2.3 Burimet e kriterëve

3.1.1 Kriteret politike

- Plani Kombëtar i Veprimit për Manaxhimin e Zhurmave në Mjedis i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.123, datë 17.2.2011;
- Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2016;
- Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2017;
- Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2018;
- Plani i Zhvillimit Strategjik për periudhën 2015 - 2020, Instituti i Shëndetit Publik;
- Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë, 14.04.2017;
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Bashkisë Tiranë, Dhjetor 2016.

2.3.1 Kriteret teknike

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 59, gërma c dhe d;
- Ligji nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis", i ndryshuar;
- Ligji nr. 39/2013, "Për disa Ndryshime në Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007, për "Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis";
- Ligji nr. 10440, datë 7.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis";
- Ligji nr. 10448, dt. 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit";
- Ligj nr. 60/2014 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 Për Lejet e Mjedisit, i ndryshuar";
- Ligji nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit";
- Ligji nr. 10138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik";
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e "Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”;
- Ligji 91/2013 për “Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
- Vendim nr. 587, datë 07.07.2010, “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”;
- Akt normativ nr. 2, 25.07.2012, “Për krijimin e Task-Forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare”;
- Udhëzim nr. 8 datë 27.12.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”;
- Udhëzim nr.5 datë 26.11.2010, “Për kriteret dhe procedurat për pajisje me Leje të Thjeshtë Mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”;
- Udhëzim nr. 1037/1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe manaxhimin e Zhurmës Mjedisore”;
- Udhëzim nr. 1, datë 19.02.2018, “Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e Planeve të Veprimit për Zhurmat”;
- Vendim nr. 25661, datë 02.07.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Administratës së Aparatit të Bashkisë së Tiranës”;
- Vendim nr. 103 datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”;
- Vendim nr. 338, datë 6.6.2018, “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar”;
- Urdhër nr. 234 datë 25.05.2015, “Për miratimin e udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”;
- Urdhër nr. 58 datë 22.12.2017, “Për ngritjen e Grupit të Punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis”;
- Urdhër nr. 420, datë 07.11.2018, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”;
- Urdhër Nr. 178, datë 22.02.2018, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”;
- Rregullore e Brendshme Nr. 2, Datë 18.07.2016 për “organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve në Nivel Qendror dhe Rajonal”;
- Rregullore e Brendshme, Instituti i Shëndetit Publik 2014;
- Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, 2014.

2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit


- Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2016 i AKM-së;
- Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2017 i AKM-së;
- Raporti i vlerësimit të prevalencës së çrregullimeve të gjumit dhe bezdisjes së popullatës nga zhurmat e trafikut urban, në qytetet kryesore të Shqipërisë, ISHP;
- Artikuj nga media e shkruar dhe elektronike;

- Progres - Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë 2018;

2.3.3 Kriteret e tjera

- Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the council of 25 June 2002;
- Implementation of Directive 2002/49/EC in EU candidate state: Experience in Croatian noise mapping projects;
- WHO.2000. Guidelines for community noise. Berglund B, Lindvall T, Schwela DH, editors. Geneva: World Health Organization.
- ICBEN 2017, 12th Congress on Noise as a Public Health Problem;
- Noise Guidelines for the European Region 2018 WHO (World Health Organization);
- Noise Strategy 2016-2026, London, UK, Department of Markets and Consumer Protection;
- Noise reduction plan for Berlin - Action Plan, 2008
- ENNAH – European Network on Noise and Health 2013 (Final Report).

2.4 PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE



2.5 Qasja/metodologjia e auditimit

Grupi i auditimit vendosi mbi qasjen e përshtatshme për zhvillimin e këtij auditimi bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë fazës studimore, komunikimet me institucionet e përfshira në auditim. Tri kanë qënë qasjet audituese që janë përdorur:

1. Duke qënë se në këtë auditim është nevojitur informacion i përgjithshëm në lidhje me tiparet dhe zakonet e një grupi të caktuar të njerëzve që kanë ndikim ose që preken direkt dhe indirekt nga zhurmat e gjeneruara në mjedis, qasja sasiore ka qënë një mënyrë mjaft e vlefshme për ta arritur këtë. Kjo qasje përfshin përpilimin e anketave dhe pyetësorëve, shqyrtimin e rezultateve dhe hartimin e statistikave.

2. Qasja cilësore duke qënë më tepër qasje problemore dhe ku problemi social nuk mund të kuantifikohet, është përdorur për atë pjesë të materialeve ku treguesit janë të pamatshëm.

3. Përveç dy qasjeve të mësipërme, për shkak të kompleksitetit të auditimit, është përdorur dhe qasja pragmatike. Kombinimi i qasjes sasiore me atë cilësore përdoret për të ndihmuar në dhënien e zgjidhjes ndaj një problemi të caktuar.

2.5.1 Metodatat/teknikat audituese

Metodat e përdorura në metodologjinë e përzgjedhur janë si vijon:

- Studim arkivor;
- Intervista, takime me drejtues të institucioneve, stafin si dhe pyetje të hapura dhe pyetësorë me shkrim, përpunim dhe analizim i përgjigjeve të tyre;
- Vëzhgim në terren i gjendjes dhe situatës për të parë nga afër problematikat që shtrohen në këtë auditim;
- Konsultim i literaturës, standardeve dhe praktikave të mira për manaxhimin e ndotjes akustike në zonat urbane.

2.6 Rezultatet e parashikuara

Auditimi i performancës me temë “Ndotja Akustike” synon të ketë një impakt të thellë manaxherial dhe kryesisht social në publik. Ky auditim, krahas përshkrimit të problematikave të manaxhimit të ndotjes akustike ka për qëllim dhënien e rekomandimeve efikase për organet vendimmarrëse me qëllim përmirësimin e të gjithë faktorëve ndikues që pengojnë efektivitetin e funksionit të politikave dhe nismave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse. Pasqyrimi në media do t’i bëjë edhe më shumë jehonë këtij auditimi duke ndërgjegjësuar dhe vendosur para përgjegjësisë institucionet përkatëse për të vepruar konform ligjit në përfitim të jetës së qytetarëve.

2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë

Rezultatet e këtij auditimi do të kenë rëndësi për legjislativin dhe ekzekutivin për arsye se këto institucione do të informohen në mënyrë të detajuar mbi çështjen e ndotjes akustike dhe veçanërisht të rezultateve të arritura nga institucionet

përgjegjëse, duke synuar kështu ndërhyrjen e tyre, aty ky paraqitet e nevojshme, me qëllim përmirësimin e këtyre të fundit.

2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit

Nga ky auditim, publiku dhe palët e interesit do të informohen lidhur me strukturat përgjegjëse për politikëbërjen dhe manaxhimin e ndotjes akustike si dhe për efektet negative që zhurmat kanë në shëndetin e banorëve.

Gjithashtu, ky auditim do të synojë ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e minimizimit të zhurmave në zonat urbane, si një objektiv gjithëpërfshirës për të mundësuar një mjedis të shëndetshëm dhe sigurt për brezat e ardhshëm.

2.6.3 Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit është përgatitur Projekt-Raporti i Auditimit, i cili iu është dërguar subjekteve të përfshira në këtë auditim:

- 1) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- 2) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- 3) Bashkia Tiranë;
- 4) Agjencia Kombetare e Mjedisit;
- 5) Instituti i Shëndetit Publik;
- 6) Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit.

Pas marrjes së opinioneve dhe vlerësimit të tyre u përgatit ky Raport Final i Auditimit dhe Vendimi përkatës, të cilët, pas aprovimit të Kryetarit, do t'u përcillen përsëri subjekteve nën auditim.

Më pas Raporti Final do të publikohet në faqen e Web-it të KLSH-së, në faqen Facebook të Departamentit të Performancës në KLSH, shtypin e përditshëm apo dhe në *workshop*-e të ndryshme dhe analiza vjetore të institucionit.

3. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

A KA QENË EFEKTIV MANAXHIMI I ZHURMAVE MJEDISORE NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR PERIUDHËN 2016-2018?

Mesazhi i auditimit

Masat e marra nga MTM dhe MSHMS, si dhe Bashkia Tiranë, për manaxhimin e zhurmave mjedisore në vendin tonë nuk kanë qenë efektive.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duke mos miratuar një sërë udhëzimesh, ka dështuar të plotësojë kuadrin ligjor mbi zhurmat mjedisore me akte nënligjore edhe pse kanë kaluar 12 vite që nga krijimi i ligjit kryesor të zhurmave.

Bashkia Tiranë nuk ka hartuar politika të përshtatshme lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore. Plani Vendor i Veprimit të zhurmave, hartëzimi i zhurmave, shpallja e zonave të qeta urbane janë disa nga detyrimet ligjore të cilat Bashkia Tiranë nuk ka arritur t'i përmbushë.

Nga ana tjetër, monitorimi i zhurmave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse si pasojë e buxhetit të vogël të alokuar nga MTM, çka evidentohet edhe në mos përmbushjen e objektivave që vetë Ministria e Turizimit dhe Mjedisit vendos.

Mosakreditimi i procesit të monitorimit të zhurmave ndikon gjithashtu në besueshmërinë e ulët të të dhënave. Mungesa e aparaturave të matjes së zhurmave në ISHMPUT, sjell vështirësi në inspektim dhe marrjen e masave konkrete kundrejt subjekteve që lëshojnë zhurma sipër normave të lejuara.

ISHP nuk ka kryer asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e zhurmave mjedisore në shëndetin e popullatës.

Megjithatë, situata mund të përmirësohet nëse të gjitha institucionet subjekt auditimi do të zbatojnë rekomandimet e lëna në këtë auditim.

3.1 A kanë qenë efektive politikat dhe legjislacioni në fuqi për zgjidhjen e problemeve të ndotjes akustike?

3.1.1 A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qenë efektive ato?

Ligji kryesor lidhur me zhurmat mjedisore është Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" i cili ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Fusha e zbatimit të këtij ligji lidhet me zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen, në zona të banuara, në mjedise në institucione publike, në parqe publike dhe hapësira të tjera, të qeta, çlodhëse, në zona të qeta në natyrë, në institucionet për fëmijë, shëndetësore, arsimore, kulturore, të kultit dhe në mjedise të tjera të ngjashme me to. Megjithatë, ky ligj nuk zbatohet për zhurmat e lëshuara nga:

- a) nga veprimtaritë ushtarake në hapësira të përcaktuara për këtë qëllim;

- b) nga veprimtaritë, që ushtrohen për të zhdukur pasojat e një fatkeqësie natyrore, të një emergjence ose të një aksidenti;
- c) gjatë përballimit të një situatë, që vë në rrezik jetën dhe pronën e njerëzve, qeniet e gjalla dhe mjedisin në përgjithësi;
- d) brenda shtëpisë, brenda mjeteve të transportit dhe brenda vendeve të punës, në rastet kur kjo nuk e kalon nivelin kufi, të miratuar për mjedisin e jashtëm³².

Këshilli i Ministrave, me anë të Vendimit nr. 123, datë 17.02.2011, vendosi miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për manaxhimin e zhurmave në mjedis³³. Ky plan veprimi, duke marrë në konsideratë eksperiencën e deritanishme, ka për qëllim analizimin, planifikimin dhe zbatimin e masave të domosdoshme për manaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave mjedisore për të shmangur efektet negative që ato kanë në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve. Burimet e zhurmave në mjedis mund të jenë të shumta, por në këtë plan veprimi janë analizuar zhurmat e shkaktuara nga transporti (rrugor, hekurudhor, ajror), aktivitetet e shërbimit social që gjenerojnë zhurma nëpërmjet muzikës (bare, restorante, pabe, disko), si dhe makineritë dhe pajisjet e ndryshme në ambientet e jashtme. Nëpërmjet këtij plani veprimi synohet të bëhet një analizë e situatës aktuale, të përgjegjësiwe institucionale dhe të boshllëqeve ekzistuese ligjore dhe organizative, si dhe të planifikohen masa të domosdoshme me afate dhe buxhet të përcaktuar për t'u ndërmarrë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve në kuadër të ligjit për administrimin mjedisor të zhurmave, të kërkesave të direktivës bazë të Bashkimit Evropian për zhurmat dhe të kërkesave të direktivave specifike që lidhen me këtë çështje. Ky dokument shërben gjithashtu për ministritë, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat e planifikimit dhe të vendim-marrjes, që të marrin në konsideratë dhe të integrojnë në planet e tyre kërkesa specifike të përcaktuara në hartat e zhurmave dhe në planet lokale të veprimit për zhurmat. Plani Kombëtar i Veprimit për manaxhimin e zhurmave në mjedis shërben si një dokument bazë dhe orientues për hartimin e planeve lokale të veprimit për manaxhimin e zhurmave në mjedis nga ana e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, kërkesë kjo që buron nga neni 8 i Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis".

Një tjetër akt nënligjor i rëndësishëm lidhur me zhurmat mjedisore është edhe Udhëzimi nr. 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara". Në këtë udhëzim i cili është realizuar në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis, neni 2, pika 2 dhe në përputhje me vlerat udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) janë përcaktuar mjediset ku ky udhëzim gjen zbatim si dhe vlerat limite të cilat aktivitetet që kryhen në këto mjedisë duhet të respektojnë.

Gjetje:

- Në MTM nuk ka asnjë sektor/drejtori/specialist të profilizuar dhe përgjegjës lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike.

³² Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", neni 2, pika 3.

³³ Ky miratim është bërë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 dhe 3 të nenit 20 të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis",

- Këshilli Teknik për Zhurmat nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar asnjëherë.³⁴
- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon rregullimin e territorit, nuk kanë miratuar udhëzimin për kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave në mjedis që në procesin e hartimit të planeve të rregullimit të territorit.
- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, nuk ka miratuar udhëzimin për rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma që në fazën e projektimit dhe gjatë ndërtimit të ndërtesave.
- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, nuk ka miratuar udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave, para se ato të vihen në përdorim.
- Ministri nuk ka miratuar formatin e regjistrit të zhurmës, si dokumenti bazë, ku pasqyrohen të dhënat dhe treguesit e saj, që rezultojnë nga monitorimi dhe matjet.
- Urdhëri i Përbashkët i Ministrave të MTM dhe MSHMS me nr. 58, datë 18.12.2017, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis”, nuk ka përmbushur objektivat e përcaktuara.
- Udhëzimi nr. 1 i Ministrisë të MTM datë 07.01.2012 “Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave” nuk është vënë në zbatim.

Konkluzione

- Mungesa e një specialisti/sektori/drejtorie në MTM lidhur me politikat e manaxhimit të zhurmave mjedisore, bën të pamundur përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në dispozitat ligjore për uljen e impaktit negativ që zhurmat shkaktojnë në mjedis dhe shëndetin publik.
- Këshilli Teknik i Zhurmave duhet të funksionojë pranë Ministrisë të MTM si një organizëm ndërinstytucional këshillimor për çështjet e zhurmës. Ai duhet të ketë në përbërje specialistë të fushave. Mungesa e KTZH ndikon në mospërmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me zhurmat mjedisore.
- Planet e rregullimit të territorit të cilët hartohen nga persona fizikë e juridikë dhe miratohen nga Organet e qeverisjes qendrore apo vendore duhet të zbatohen kërkesa për reduktimin e zhurmës në mjedis. Kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave në mjedis që në procesin e hartimit të planeve të rregullimit të territorit përcaktohen dhe miratohen me udhëzim të posaçëm nga MTM në bashkëpunim me Ministrin që mbulon rregullimin e territorit³⁵. Mungesa e një udhëzimi të tillë sjell mangësi në cilësinë e kërkesave të reduktimit të zhurmave në planet rregullatore.
- Projektimet për ndërtime, rikonstruksione ndërtesash për banim apo veprimtari ekonomike e shoqërore, realizohen të tilla që zhurmat në brendësi apo në afërsi të saj të jenë brenda nivelit kufi. Mungesa e Udhëzuesve nga MTM dhe Ministria përgjegjëse për punët publike në përcaktimin e kriterëve teknike dhe të masave mbrojtëse ndaj zhurmave që në fazën e projektimit, ndërtimit dhe para përdorimit të ndërtesave çojnë në ekspozimin e banorëve ndaj zhurmave duke rritur efektet negative që ato (zhurmat) sjellin në shëndet.
- Miratimi i formatit të regjistrit të zhurmave ndihmon në ngritjen e një strukture funksionale informative mbi subjektet e pajisura me leje mjedisore, nga ku çdo

³⁴ Ligj nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 6.

³⁵ Ligj nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 13.

person fizik dhe juridik hedh të dhënat për zhurmat që emetohen nga veprimtaria e tyre.

- Urdhëri i Përbashkët i Ministrave të MTM dhe MSHMS me nr. 58, datë 18.12.2017, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis”, ka të përcaktuara qartë një sërë detyrash si për shembull evidentimin e subjekteve të pajisura me leje mjedisi, ato që gjenerojnë zhurma në mjedis etj. Ky grup pune duhet të raportojë mbi përmbushjen e detyrave të përcaktuara për të. Mos funksionimi i këtij grupi pune ka sjellë mospërmbushjen e objektivave të parashikuara në urdhërin e sipër cituar.
- Edhe pse është miratuar nga Ministri i MTM, Udhëzimi nr. 1 datë 07.01.2012 “Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave”, hartëzimi i zhurmave nuk është bërë as në nivel kombëtar dhe as në nivel lokal. Hartat strategjike të zhurmave kanë si qëllim sigurimin e të dhënave lidhur me zhurmat, sigurimin e informacionit për qytetarët, si dhe për hartimin e planeve të veprimit.

Rekomandime

- MTM si institucion përgjegjës për hartimin e politikave mbi manaxhimin e zhurmave mjedisore, të marrë masat e nevojshme për vendosjen në organigramën përkatëse të paktën një specialist/sector ku misioni dhe detyrat kryesore të tyre të jenë lidhur me zhurmat mjedisore.

Janar 2020

- Ministri i MTM të propozojë në Këshillin e Ministrave ngritjen e Këshillit Teknik për Zhurmat (KTZH), si organizëm ndërinstytucional këshillimor për çështjet e zhurmës.

Dhjetor 2019

- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon rregullimin e territorit, të miratojë udhëzimin për kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave në procesin e hartimit të planit të rregullimit të territorit.

Janar 2020

- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, të miratojë udhëzimin për rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma që në fazën e projektimit dhe gjatë ndërtimit të ndërtesave.

Janar 2020

- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, të miratojë udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave, para se ato të vihen në përdorim.

Janar 2020

- Ministri i MTM të miratojë formatin e regjistrit të zhurmës, si dokumenti bazë, ku pasqyrohen të dhënat e treguesit e saj, që rezultojnë nga monitorimi dhe matjet.

Dhjetor 2019

- MTM dhe MSHMS të marrin masat e nevojshme për vënien në zbatim dhe raportimin periodikisht të Urdhërit të Përbashkët të Ministrave të MTM dhe MSHMS me nr. 58,

datë 18.12.2017, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis”.

Dhjetor 2019

- MTM të marrë masat për të vënë në zbatim Udhëzimin nr. 1 të Ministrit të MTM datë 07.01.2012 “Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave”.

Qershor 2020

3.1.2 A janë hartuar dhe zbatuar politika të përshtatshme nga Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore?

Bashkia Tiranë, referuar Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis, neni 8, brenda juridiksionit të saj është përgjegjëse për:

- Drejtimin, hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga Këshilli i Bashkisë.
- Drejtimin e procesit të hartëzimit të zhurmës.
- Shpalljen e zonave të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosjen e kufizimeve të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.
- Kërkimin nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës.

Drejtorja e Politikave dhe Edukimit Mjedisor është përgjegjëse për mirë administrimin e çdo çështjeje që lidhet me zhvillimin e politikave, planeve për mbrojtjen e mjedisit urban, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së banorëve, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Tiranës dhe territoreve përreth. Gjithashtu, një ndër detyrat kryesore të kësaj drejtorie është adaptimi i politikave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit në nivelin e Bashkisë së Tiranës duke përcaktuar objektivat e zhvillimit dhe indikatorët për matjen e realizimit të tyre në nivel lokal³⁶.

Bashkia Tiranë nëpërmjet Vendimit nr. 3183, datë 01.02.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë ka miratuar “Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës”. Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK) në themel të punës së saj ka mbrojtjen e disa të drejtave të konsumatorit. AMK nëpërmjet Sektorit të Kontrollit të Ndotjeve dhe Shërbimeve të Transportit Publik kontrollon shërbimet e ofruara për qytetarët nga operatorët e transportit publik si dhe hapësirat publike në lidhje me ndotjet e ndryshme të ushtruara nga qytetarët apo subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë së Tiranës. Ai monitoron, evidenton dhe merr masa ndaj subjekteve në lidhje me ndotjet e shkaktuara nga zhurmat në mjedis në territorin urban. Bashkia Tiranë, nëpërmjet Drejtorisë së Transportit e Trafikut Rrugor, harton studimet dhe projektimet dhe parashikon kostot e shenjave të trafikut, shenjzimeve vertikale, horizontale,

³⁶ Rregullore për “Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës”, fq. 35.

impianteve të semaforëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre, ashtu si dhe impianteve të tjera teknologjike të destinuara për disiplinimin dhe sigurinë e trafikut.³⁷ Në qytetin e Tiranës ashtu si dhe në qytete të tjera të Shqipërisë është e domosdoshme parashikimi i ndërhyrjeve në sinjalistikën rrugore dhe përfshirja në të e sinjaleve që lidhen me zhurmat, si dhe vendosjen e këtyre sinjaleve në zona të caktuara³⁸. Në vende të Bashkimit Evropian, për reduktimin e zhurmave të trafikut rrugor përdorin tabela sinjalizuese si më poshtë:

Foto 4. Tabelë e vendosur në Berlin që detyron ulje të shpejtësisë gjatë natës



Burimi: Noise and its Abatement, "Sustainable transport: A sourcebook for policy-makers in developing cities", Berlin

Foto 5. Tabela që ndalojnë zhurmat e panevojshme dhe rënien e borieve në zonat rezidenciale dhe ato të qeta



Burimi: Studim mbi ndotjen akustike në Tiranë dhe mënyrat optimale për reduktimin e saj në ndërtesa" Doktoraturë, L. Aleksi

³⁷ Rregullore e Bashkisë Tiranë, 2018, fq 62.

³⁸ Plani Kombëtar i Manaxhimit të zhurmave në mjedis, fq 9.

Foto 6. Tabelë që ndalon rënien e bories në zonat e banuara, duke përjashtuar rastet e paralajmërimit të një rreziku të mundshëm.



Burimi: <https://www.conserve-energy-future.com/easy-and-practical-ways-to-reduce-noise-pollution.php>

Një tjetër praktikë e mirë e marrë në konsideratë në këtë auditim nga grupi i auditimit është edhe Raporti i hartëzimit të zhurmave i kryer nga Bashkia e Milanos. Ky raport përshkruan metodologjinë e ndjekur për matjen e nivelit të zhurmave në *aglomeratin*³⁹ e Milanos të gjeneruara nga burime të ndryshme zhurmash si infrastruktura rrugore, hekurudhore, aeroportuale dhe nga aktiviteti industrial. Krahas përshkrimit të metodologjisë për matjen e zhurmave në këtë raport rëndësi të madhe i kushtohet edhe ekspozimit të popullsisë nga zhurmat mjedisore. Gjithashtu janë llogaritur edhe numri i shkollave dhe spitaleve (si objekte me rëndësi të veçantë) të cilat ekspozohen ndaj niveleve të ndryshme të zhurmave. Ekspozimi i popullsisë ndaj zhurmave në këtë studim është bërë i veçantë për secilin prej burimit të zhurmave. Përcaktimi i zonave të qeta është një tjetër element mjaft i rëndësishëm i realizuar nga ky studim i cili përveç se ka vendosur kritere më të forta sa i përket nivelit të zhurmave të lejuara, ka përcaktuar kufijtë e këtyre zonave si dhe ka vendosur për aktivitetet të cilat lejohen të zhvillohen në këto zona. Në tabelën 7 dhe 8 janë paraqitur të dhënat e ekspozimit të popullsisë respektivisht nga zhurmat e transportit rrugor dhe aktivitetit industrial.

³⁹ Bazuar në Direktivën Evropiane të Zhurmave 2002/49/EC, **aglomerat** nënkupton një pjesë të një territori të kufizuar nga Shteti Anëtar, me një popullsi më të madhe se 100 000 njerëz dhe një dendësi të popullsisë të tillë që Shteti Anëtar e konsideron atë një zonë të urbanizuar.

Tab. 6 Rezultatet e ekspozimit (për Milanon) ndaj zhurmave të trafikut rrugor

		Popullata e ekspozuar	Ndertesat e banuara	Shkolla	Spitale
Intervali Lden	55-59	173.202	12.081	128	12
	60-64	220.563	13.818	255	40
	65-69	242.551	14.641	253	33
	70-74	207.672	11.766	227	37
	>75	108.016	5.337	64	12
Intervali Lnight	50-54	208.054	12.963	218	30
	55-59	223.789	13.377	238	31
	60-64	191.082	11.318	225	37
	65-69	141.537	7.376	100	17
	>70	25.465	1.08	13	3

Burimi: Mappa Acustica Strategica, Comune di Milano, 2014, fq. 18

Tab. 7 Rezultatet e ekspozimit (për Milanon) ndaj zhurmave të aktiviteteve industriale

		Popullata e ekspozuar	Ndertesat e banuara	Shkolla	Spitale
Intervali Lden	55-59	923	98	1	1
	60-64	299	14	2	1
	65-69	330	49	0	0
	70-74	0	0	0	0
	>75	0	0	0	0
Intervali Lnight	50-54	58	24	0	0
	55-59	0	0	0	0
	60-64	0	0	0	0
	65-69	0	0	0	0
	>70	0	0	0	0

Burimi: Mappa Acustica Strategica, Comune di Milano, 2014, fq. 38

Gjetje

- Bashkia Tiranë nuk ka miratuar Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.
- Bashkia Tiranë nuk ka realizuar hartëzimin e zhurmave për qytetin e Tiranës.
- Bashkia Tiranë nuk ka shpallur zona të qeta në territorin që ajo administron.
- Bashkia Tiranë nuk ka vendosur në asnjë rast sinjalistikën e nevojshme për kufizimin/ndalimin e përdorimit të borive.

- Orari i punimeve në lejet e ndërtimit që Bashkia e Tiranës miraton, nuk është i përcaktuar.
- Bashkia Tiranë nuk ka vendosur kritere për përdorimin e materialeve të izolimit akustik në lejet e ndërtimit.
- Bashkia Tiranë nuk ka asnjë të dhënë mbi numrin e popullsisë së ekspozuar në territorin e Bashkisë së Tiranës.
- Drejtoria e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile në BT, nuk e ka të përshkruar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Tiranë përgjegjësinë për dhënien e opinionit për subjektet që aplikojnë për leje mjedisi.

Konkluzione

- Plani Vendor i Veprimit për zhurmat i cili nuk është miratuar nga Bashkia Tiranë hartohet për të manaxhuar problemet dhe pasojat e zhurmës, përfshirë pakësimin e saj deri në nivelin kufi. Gjatë periudhës së këtij auditimi, Bashkia Tiranë, me anë të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr. 16236, datë 15.04.2019, ka ndërmarrë “Nismën për hartimin e Planit të Veprimit mbi zhurmat – për Bashkinë Tiranë”.
- Hartëzimi i zhurmës i cili gjithashtu nuk është realizuar nga Bashkia Tiranë, është paraqitja me indikatorë e të dhënave për zhurmën, për një gjendje ekzistuese ose të parashikuar, që tregon kapërcimin e nivelit kufi, numrin e njerëzve të ndikuar në një zonë të caktuar ose numrin e banesave të ekspozuara ndaj disa vlerave të indikatorit të zhurmës në atë zonë. Hartëzimi i zhurmave realizohet dhe duhet të jetë në sinkron me Planin Vendor të Veprimit për zhurmat⁴⁰.
- Përcaktimi i zonave të qeta të cilat nuk janë shpallur nga Bashkia Tiranë, duhet bërë në përputhje me Planin Vendor të Veprimit. Këto zona nuk ekspozohen ndaj zhurmave me vlerë më të lartë se një vlerë kufi e caktuar.
- Sinjalistika për reduktimin e zhurmave mjedisore si për shembull ndalimi i përdorimit të borive, kufizimi i shpejtësisë etj., janë rekomandime të lëna edhe në Vlerësimin Strategjik Mjedisor 2016 (fq. 125) të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë. Mungesa e sinjalistikës ka çuar në mos përmbushjen e objektivave të vendosura nga Bashkia Tiranë në VSM lidhur me reduktimin e zhurmave mjedisore.
- Në formularët e aplikimit dhe në lejet e ndërtimit që Bashkia Tiranë miraton nuk janë të përcaktuara oraret në të cilat duhet të kryhen punimet e ndërtimit nga subjektet që përfitojnë leje ndërtimi. Mos vendosja e orareve të caktuara se kur duhet të kryhen punimet, bën që në mjaft raste të punohet në orët e vona të natës duke sjellë shqetësim për banorët e Tiranës. Mos përcaktimi i orareve të punimit në lejet e ndërtimit, sjell pamundësi nga ana e inspektorëve vendorë për marrjen e masave administrative për subjektet që ndërtojnë natën.
- Materialet e izolimit akustik janë shumë të rëndësishme sa i përket reduktimit të zhurmave mjedisore në ambientet e brendshme të banimit. Bashkia Tiranë duke mos vendosur kritere fikse për subjektet/kompanitë e ndërtimit mbi llojet e materialeve izolues-akustik që duhet të përdorin, nuk ndikon në përmirësimin e cilësisë së godinave sa i përket reduktimit të zhurmave.

⁴⁰ Plani Kombëtar i Veprimit për manaxhimin e zhurmave në mjedis, 2011, fq 3;

- Ekspozimi i popullsisë ndaj zhurmave mjedisore është i lidhur ngushtë me hartëzimin e zhurmave. Praktika të mira ndërkombëtare gjatë realizimit të raporteve të hartëzimit të zhurmave identifikojnë zonat me efekte më të theksuara të zhurmave, burimet e ndryshme të zhurmave si dhe popullsinë e ekspozuar dhe të prekur ndaj këtyre zhurmave⁴¹. Raporti i hartëzimit të zhurmave i kryer nga Bashkia e Milanos është një shembull i mirë se si mund të realizohen raporte të tilla nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me institucione kërkimore shkencore, Universitete etj.
- Bazuar në Udhëzimin nr. 5 të Ministrit të MTM, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, pika 3, gërma f, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të shprehin opinionin e tyre për veprimtaritë e subjekteve private para se këto të aplikojnë për leje mjedisi. Në Bashkinë e Tiranës struktura përgjegjëse për dhënien e këtij opinionin është Drejtoria e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile. Kjo përgjegjësi i është ngarkuar kësaj Drejtorie me anë të shkresës së Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr. Prot. 11205/2, datë 4/5/2016 edhe pse nuk është e përshkruar në rregulloren e brendshme të saj.

Rekomandime

- Bashkia Tiranë të hartojë dhe të miratojë me Vendim të Këshillit Bashkiak Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.
Qershor 2020
- Bashkia Tiranë të drejtojë procesin e hartëzimit të zhurmave pas miratimit të Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.
Dhjetor 2020
- Bashkia Tiranë të shpallë zona të qeta në përputhje me Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.
Dhjetor 2020
- Bashkia Tiranë të marrë masa për të vendosur sinjalistikën e nevojshme për kufizimin/ndalimin e përdorimit të borive në zona të caktuara të territorit të Bashkisë Tiranë.
Dhjetor 2019
- Bashkia Tiranë të marrë masa për të vendosur kufizime lidhur me orarin e ndërtimit në “lejet e ndërtimit” që ajo miraton.
Dhjetor 2019
- Bashkia Tiranë të marrë masa për të vendosur kritere rregullatore për përdorimin e materialeve të izolimit akustik në lejet e ndërtimit që ajo miraton.
Dhjetor 2019

⁴¹ Mappa Acustica Strategica, Comune di Milano, 2014.

- Bashkia Tiranë të realizojë raporte duke identifikuar dhe vlerësuar numrin e popullsisë së ekspozuar ndaj zhurmave mjedisore në territorin që ajo administron⁴².

Qershor 2020

- Bashkia Tiranë të marrë masat për të ndryshuar Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe të funksionimit të saj duke përshkruar qartësisht në këtë rregullore strukturën përgjegjëse për dhënien e opinionit për subjektet që aplikojnë për leje mjedisi në përputhje me Udhëzimin nr. 5 të Ministrit të MTM, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, pika 3, gërma f.

Qershor 2020

3.2 A ka patur impakt negativ ndotja akustike në shëndetin publik?

3.2.1 A kanë qenë efektive politikat e ndërmarra nga MSHMS për mbrojtjen e shëndetit publik nga zhurmat mjedisore?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një sërë detyrimesh që lidhen me masat e domosdoshme për të garantuar shëndetin e njerëzve nga zhurmat e gjeneruara, si dhe me masat e domosdoshme që duhen ndërmarrë në këtë drejtim. Kjo ministri duhet të bëjë vlerësime të shkallës së ndikimit të zhurmave në shëndetin e njerëzve dhe të propozojë masa specifike të domosdoshme, duke u përqendruar në kërkesat e veçanta që kanë objektet, si: shkolla, spitale, kopshte, çerdhe etj.⁴³ Bazuar në Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 5, pika 2, MSHMS është organi kryesor përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga zhurmat. MSHMS nëpërmjet hartimit të politikave synon reduktimin e ndikimeve negative të zhurmave. MSHMS, pas vitit 2007 kur është miratuar ligji kryesor i zhurmave në mjedis, e deri më sot ka miratuar disa akte nënligjore duke nxjerrë udhëzime të përbashkëta me Ministrinë e Mjedisit si për shembull Udhëzimi nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara si dhe Urdhërin nr. 234 datë 25.05.2015 “Për miratimin e udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”. Gjithashtu, MSHMS së bashku me MTM kanë hartuar Urdhërin e përbashkët nr. 58 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis” me nr. Prot. 5446, datë 22.12.2017. Krahas këtyre udhëzimeve, grupi i auditimit, me rekomandimin edhe të ekspertëve të Institutit të Shëndetit Publik ka marrë në konsideratë si një praktikë të mirë “Udhëzimin mbi matjen e emetimit të zhurmave” nga Kantoni Ticino në Zvicër⁴⁴. Departamentit të Territorit, Sektorit të mbrojtjes së ajrit, ujit dhe tokës në Kantonin Ticino (Zvicër) i është besuar detyra e përgatitjes së Udhëzuesit për matjen dhe protokollimin e emetimeve të zhurmës nga trafiku rrugor dhe jo vetëm. Në këtë Udhëzues krahas përshkrimit të metodologjisë për monitorimin e transportit rrugor jepet një tablo më e qartë mbi strukturën legislative aktuale (si ligji zviceran dhe ai

⁴²https://www.google.com/search?q=Mappa+Acustica+Strategica%2C+Comune+di+Milano%2C+2014&rlz=1C1GGRV_enAL751AL751&oq=Mappa+Acustica+Strategica%2C+Comune+di+Milano%2C+2014&aqs=chrome..69i57.928j0j7&sourceid=chrome&ie=UTF-8

⁴³ Vendim nr. 123, datë 17.2.2011 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për manaxhimin e zhurmave në mjedis”, fq.10.

⁴⁴ Guidelines on the measurement of noise immissions along Alpine crossings, Dr. Angelo Bernasconi Dr. Dario Bozzolo, Bellinzona, 2012.

italian mbi zhurmat, si dhe Direktiva e BE-së 2002/49/EC, e njohur si Direktiva e zhurmave mjedisore), projektet, standardet dhe referencat bibliografike në të cilën mbështetet ky udhëzues, si dhe shembuj nga zbatimi në praktikë i udhëzuesit.

Gjetje

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në organikën e saj nuk ka asnjë drejtori/sector/specialist përgjegjës për hartimin e politikave në lidhje me zhurmat mjedisore.
- Në “Udhëzuesin për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, miratuar me urdhër nr. 234 datë 25.05.2015 nga MSHMS, në kapitullin “Metodologjia e matjeve të zhurmave në rrugë” nuk përcaktohet saktë **frekuenca ose kohëzgjatja** në të cilën duhet bërë monitorimi i zhurmave në një pikë monitorimi.

Konkluzione

- Mungesa e një specialisti/sectori/drejtorie në MSHMS lidhur me politikën e manaxhimit të zhurmave mjedisore dhe efekteve që ato kanë në shëndetin publik, bën të pamundur përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në dispozitat ligjore për uljen e impaktit negativ që zhurmat shkaktojnë në popullatë.
- “Udhëzuesi për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, i miratuar me Urdhër nr. 234 datë 25.05.2015 nga Ministri i MSHMS, është dokumenti bazë që përcakton metodikat dhe rregullat e vlerësimit të zhurmave në mjedis dhe në vende pune nëpërmjet matjeve dhe monitorimit, me qëllim evitimin, parandalimin dhe pakësimin e tyre me synimin për mbrojtjen e shëndetit të banorëve dhe punëmarrësve, duke përfshirë bezdinë dhe ekspozimin ndaj zhurmave në mjedis. Në këtë udhëzues citohet vetëm se “matja e zhurmave që krijohet të bëhet për një kohë **jo më të vogël se 1 javë**”, duke mos saktësuar se kjo periudhë “një javë” i referohet një javë në muaj, një javë në stinë apo një javë në vit.

Rekomandime

- MSHMS të krijojë një sektor në organikën e saj ose të ngarkojë me përgjegjësi të paktën një person me formim dhe eksperiencë në fushën e zhurmave dhe efekteve që ato japin në shëndet.

Dhjetor 2019

- **Frekuenca ose kohëzgjatja** sa i përket numrit të ditëve që duhet bërë monitorimi i zhurmave në një pikë monitorimi duhet të përcaktohet saktë në “Udhëzuesin për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, dhe të jetë disa ditë në stinë⁴⁵. MSHMS të marrë masa për ndryshimin e “Udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, (miratuar me urdhër nr.234 datë 25.05.2015) në përputhje me praktikën zvicerane.

Dhjetor 2020

⁴⁵ Guidelines on the measurement of noise immissions along Alpine crossings, Dr. Angelo Bernasconi Dr. Dario Bozzolo, Bellinzona, 2012, fq. 16.

3.2.2 A ka evidenca, raporte apo studime nga institucionet përkatëse mbi efektet negative të zhurmave në shëndetin publik?

Institucioni kryesor që ka për detyrë vlerësimin e ndikimit të zhurmave në shëndetin e popullatës është Instituti i Shëndetit Publik. Departamenti i Shëndetit dhe Mjedisit është qendër reference kombëtare për çështjet e lidhura me ujin e pijshëm, cilësinë e ajrit, sigurinë ushqimore, fizikën sanitare dhe të gjitha çështjet e tjera të lidhura me shëndetin dhe mjedisin. Qëllimi final i të gjithë veprimtarisë së këtij departamenti është përmirësimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e shëndetit të popullatës nga kërcënimet mjedisore. Ne Rregulloren e Brendshme të ISHP (2014) neni 22, pika “e”, citohet “Ekspertiza në mbrotjen e popullatës nga zhurmat dhe vibracionet, si agjentë rreziku për shëndetin mendor dhe më gjerë” si një nga drejtimet kryesore të aktivitetit të Departamentit të Shëndetit dhe Mjedisit. Sektori i Fizikës Sanitare i cili është pjesë e Departamentit të Shëndetit dhe Mjedisit në ISHP ka si qëllim të punës njohjen dhe zbatimin e ligjshmërisë së shëndetit publik me fokus fizikën sanitare, në fushat e ndotjes akustike, vibracioneve, valëve elektromagnetike e rrezatimeve të tjera, etj., për vlerësimin e ekspozimit dhe ndikimit në shëndetin e popullatës dhe punëmarrësve, nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe ekspertizës analitiko-shkencore. Detyrat e Sektorit të Fizikës Sanitare janë si më poshtë:

- a) Nëpërmjet zbatimit të ligjshmërisë dhe monitorimit, vlerësimit dhe ekspertizës sanitare të arrihet njohja e situatës së ndotjes nga faktorët fizik në mjediset e hapura dhe të mbyllura.
- b) Vlerësimi i ndikimit në shëndetin e popullatës dhe punëmarrësve nga faktorë të ndryshëm fizik.
- c) Organizimi dhe kryerja e ekspertizave sanitare për vlerësimin e ndotjes akustike dhe elementeve të tjera të fizikës sanitare.
- d) Përgatitja dhe trajnimi i specialistëve të shëndetit publik në fushën e fizikës sanitare.
- e) Përgatitja e materialeve shkencore përmbledhëse në fushën e ekspozimit ndaj faktorëve fizik në popullatë dhe ndikimit në shëndet.
- f) Bashkëpunimi me strukturat e tjera qendrore e vendore në fushën e fizikës sanitare.
- g) Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë me rrjetin e institucioneve të tjera të shëndetit publik, për monitorimin, vlerësimin dhe ekspertizën në fushën e fizikës sanitare.⁴⁶

Gjithashtu një tjetër institucion i rëndësishëm sa i përket lidhjes midis zhurmave mjedisore dhe efekteve të tyre në popullsi është dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit. AKM, në zbatim të VKM-së nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (PKMM) harton çdo vit PKMM i cili më pas miratohet nga Ministri i MTM-së. Bazuar në të njëjtën VKM, AKM harton Raportin e Gjendjes së Mjedisit -RGJM (çdo vit) ku paraqiten, komentohen dhe analizohen treguesit mjedisorë, si dhe jepen rekomandimet për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Një kapitull të veçantë si në PKMM ashtu edhe në RGJM zënë edhe zhurmat mjedisore. Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (2017) theksohet se “monitorimi i nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 10

⁴⁶ Rregullore e Brendshme Instituti i Shëndetit Publik 2014, neni 24.

qyteteve kryesore të vendit bëhet me qëllim që të vlerësohet *masa e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave*".⁴⁷

Organizata Botërore e Shëndetësisë së bashku me JRC⁴⁸ në Komisionin Evropian në 2011 kanë realizuar një studim mbi përlllogaritjen e viteve të humbura të jetës si rezultat i zhurmave mjedisore⁴⁹. Ky studim përmban përmbledhje të sintetizuara të dëshmive mbi marrëdhëniet midis zhurmës mjedisore dhe efekteve specifike të shëndetit, duke përfshirë sëmundjen kardiovaskulare, dëmtimin njohës, shqetësimin e gjumit dhe tringëllimë në veshët. Gjithashtu përfshihet edhe një kapitull për bezdinë. OBSH filloi të vlerësojë barrën globale të sëmundjes (GBD) në gjysmën e dytë të viteve 1990. Barra mjedisore e sëmundjes për shkak të faktorëve të mjedisit si plumbi, ndotja e ajrit të jashtëm dhe të brendshëm, ujit dhe kushteve higjieno sanitare u botua në 2002. Qendra Evropiane për Mjedisin dhe Shëndetin e OBSH-së, zhvilloi më tej disa takime për të vlerësuar barrën mjedisore të sëmundjes ndaj ekspozimit të zhurmave mjedisore. Përfundimet dhe rekomandimet e këtyre takimeve janë përmbledhur në këtë studim të cilin grupi i auditimit me temë "ndotja akustike" e ka marrë në konsideratë si një praktikë e mirë mbi të cilin institucionet shqiptare mund të thellohen dhe më shumë në arritjen e objektivave të tyre. Për të vlerësuar barrën mjedisore të sëmundjes (*EBD-Environmental Burden of Disease*) për shkak të zhurmës së mjedisit, duhet të përdoret një qasje sasiore e vlerësimit të rrezikut. Vlerësimi i rrezikut i referohet identifikimit të rreziqeve, vlerësimit të ekspozimit të popullsisë dhe përcaktimi i marrëdhënies së duhur ndaj "ekspozim-shfaqjes". Barra mjedisore e sëmundjes (*EBD*) shprehet nëpërmjet "*DALY*" (*disability-adjusted life years*) e cila është shumatorja e "*YLL*" (*years of life lost* - vitet e humbura të jetës) dhe "*YLD*" (*years lived with disability* - vitet e jetuara me paaftësi).⁵⁰ Në konkluzionet e studimit të OBSH-së dhe JRC u vlerësua se humbja e viteve të jetës dhe viteve të jetuara me paaftësi (*DALY*) në vendet perëndimore të Evropës ishte 61 000 vjet për sëmundjen ishemike të zemrës, 45 000 vjet për anomali të lindura të fëmijëve, 903 000 vjet për çrregullime të gjumit, 22 000 vjet për "*tinitus*" dhe 654 000 vjet për bezdi. Duke marrë në konsideratë të gjitha këto barra e sëmundjeve nga zhurmat e shprehur në "*DALY*" do të ishte 1-1.6 milionë vjet. *Tinitusi* është ndjesia e të perceptuarit të zhurmave edhe kur realisht nuk ka zhurma. Ai mund të shkaktojë shqetësim ndaj gjumit, ankth, tension, depresion, frustrim, çrregullime psikologjike, pamundësi për të punuar,⁵¹ e deri në humbje të dëgjimit. *Tinitusi* mund të shkaktohet nga disa faktorë: ku një ndër më kryesorët është ekspozimi ndaj zhurmave të larta. Në vendin tonë edhe pse është vërejtur se të rinjtë frekuentojnë klubet e natës, ku niveli i zhurmave arrin në 100dB nuk ka të dhëna mbi incidencën e *Tinitusit*⁵². Bezdisja dhe pagjumësia lidhur me zhurmat nga trafikur rrugor përbëjnë barrën kryesore të zhurmave mjedisore në vendet evropiane. Në këtë raport theksohet gjithashtu edhe mungesa e të dhënave në vendit e rajonit jug lindor të Evropës (ku bën

⁴⁷ Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2017, fq 8.

⁴⁸ JRC (Joint Research Center) është një Drejtori e Përgjithshme në KE ku janë të punësuar shkencëtarë të cilët kryejnë studime kërkimore shkencore me qëllim mbështetjen e politikave të BE-së.

⁴⁹ Burden of disease from environmental noise, WHO & JRC European Commission, 2011.

⁵⁰ Burden of disease from environmental noise, WHO & JRC European Commission, 2011, fq 14 & 15.

⁵¹ Burden of disease from environmental noise, WHO & JRC European Commission, 2011, fq 17.

⁵² Punim shkencor, "Zhurma në mjediset ku luhet muzikë e lartë dhe impakti i tij tek gjimnazistët", Arta AGO, Prof. Dr. Ylli SAROLLI, Prof. Asc. Arben LUZATI.

pjesë dhe Shqipëria) duke bërë të mundur mos vlerësimin e barrës së sëmundjeve nga zhurmat⁵³.

Sipas një raporti të bërë nga Agjencia Mjedisore Federale (Umweltbundesamt) e Gjermanisë theksohet se studimet epidemiologjike vërtetojnë shtimin e sëmundjeve kardiovaskulare, duke përfshirë hipertensionin dhe sëmundjet ishemike të zezës (ose infarkti i miokardit siç quhet ndryshe në gjuhën mjekësore). Të dhënat e këtij raporti dëshmojnë për rreth 4000 raste në vit (përlllogaritjet janë bërë për Gjermaninë në vitin 1999) për sëmundjet ishemike të zezës që vijnë nga zhurmat mjedisore. Raporti gjithashtu thekson se nëse niveli i zhurmave ditore nuk do t'i kalonte 60 dB, nuk do të kishte raste të sëmundjeve ishemike të zezës nga zhurmat mjedisore⁵⁴.

Gjetje

- ISHP, ka realizuar në vitin 2014 lidhur me zhurmat mjedisore Raportin me temë “Vlerësimi i prevalencës së çrregullimeve të gjumit dhe bezdisjes së popullatës nga zhurmat e trafikut urban, në qytetet kryesore të Shqipërisë”.
- ISHP nuk ka mundur të vlerësojë barrën mjedisore në shëndet si rezultat i zhurmave mjedisore.
- ISHP nuk ka mundur të vlerësojë nëpërmjet studimeve epidemiologjike efektet negative në shëndet të zhurmave mjedisore për sëmundje të caktuara si për shembull sëmundje kardiovaskulare, hipertension, etj.
- ISHP nuk ka asnjë metodologji/manual/udhëzim për të vlerësuar barrën mjedisore të zhurmave duke përllogaritur “YLL” (Vitet e humbura të jetës) dhe “YLD”, (Vitet e jetuara me paaftësi).
- AKM nuk ka të dhëna mbi ekspozimin e popullatës ndaj zhurmave mjedisore.

Konkluzione

- Raporti i vetëm në lidhje me zhurmat mjedisore që ISHP ka realizuar është ai i vitit 2014 me temë “Vlerësimi i prevalencës së çrregullimeve të gjumit dhe bezdisjes së popullatës nga zhurmat e trafikut urban, në qytetet kryesore të Shqipërisë”. Ky raport i përmend teorikisht barrën e sëmundjes, DALY, etj., por nuk ofron asnjë të dhënë apo përllogaritje konkrete për rastin e vendit tonë.
- Studimet epidemiologjike janë shumë të rëndësishme për të vlerësuar lidhjen shkak pasojë midis zhurmave mjedisore dhe sëmundjeve të ndryshme si ato kardiovaskulare etj. Fakti që ISHP nuk ka të dhëna mbi këto sëmundje bën të pamundur vlerësimin e efektit real që ato (zhurmat) japin në shëndetin e popullatës. Pamundësia për të realizuar studime epidemiologjike, ku të bëhet i mundur vlerësimi i barrës mjedisore të sëmundjes, përllogaritjeve të YLL dhe YLD lidhet edhe me performancën jo të mirë të shërbimit parësor shëndetësor si dhe me ngarkesën⁵⁵ që sektori i Fizikës Sanitare në ISHP ka në trajtimin e ankesave lidhur

⁵³ Burden of disease from environmental noise, WHO & JRC European Commission, 2011, fq 18.

⁵⁴ Transportation Noise and Cardiovascular Risk, Review and Synthesis of Epidemiological Studies, Dr. Wolfgang Babisch, Federal Environmental Agency, Berlin - Germany, 2006.

⁵⁵ Në tre vite (2016-2018) ISHP nëpërmjet Sektorit të Fizikës Sanitare ka realizuar rreth 250 matje në total të nivelit të zhurmave. Kujtojmë se për të realizuar një raport të plotë mbi ankesat apo matjet për subjektet që kërkojnë të pajisen me leje mjedisi, këtij Sektorit në ISHP i duhen afërsisht 2-3 ditë pune ku angazhohen 2 specialistë nga 4 që është numri total i punonjësve në këtë sektor.

me zhurmat por edhe me kryerjen e matjeve për subjektet që aplikojnë për leje mjedisi.

- Mungesa e një metodologjie apo manuali për vlerësimin e YLL dhe YLD është një ndër faktorët kryesorë që ISHP e ka të pamundur përlllogaritjen e këtyre treguesve.
- Ekspozimi i popullatës ndaj zhurmave mjedisore është një komponent shumë i rëndësishëm që ndihmon në marrjen e masave me qëllim zbutjen e efekteve negative që zhurmat japin në shëndetin e popullatës. Edhe pse në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit 2017 (Kapitulli i Zhurmave, faqe 8) theksohet masa e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave, aktualisht AKM nuk ka të dhëna.

Rekomandime

- ISHP të marrë masa për realizimin e studimeve epidemiologjike dhe përlllogaritjen e barrës mjedisore nga zhurmat në shëndetin e popullatës të vendit tonë.

Dhjetor 2020

- ISHP të marrë masa për të realizuar një manual/metodologji për përlllogaritjen dhe vlerësimin e YLL dhe YLD duke u bazuar në studimin e OBSH dhe Komisionit Evropian⁵⁶. (*Burden of disease from environmental noise, WHO & JRC European Commission, 2011*)

Dhjetor 2020

- AKM me qëllim zbatimin me përpikmëri të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit të bëjë të mundur vlerësimin e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave mjedisore dhe ta pasqyrojë në Raportet e Gjendjes së Mjedisit (RGJM).

RGJM i vitit 2020 e në vazhdim

3.3 A është efektiv sistemi i monitorimit dhe inspektimit për zhurmat mjedisore?

3.3.1 A është i besueshëm dhe efektiv monitorimi i zhurmave nga AKM dhe ISHP?

Monitorimi i mjedisit (pjesë e të cilit është dhe monitorimi i zhurmave) shërben për grumbullimin e të dhënave të nevojshme si dhe për vlerësimin e prirjeve dhe zhvillimit kombëtar të mjedisit. Në këtë mënyrë monitorimi jep një informacion më të saktë dhe më të shpeshtë për publikun e interesuar, duke ndihmuar përfshirjen e më shumë subjekteve dhe individëve në vendimmarrjen mjedisore.⁵⁷ Monitorimi i zhurmave kryhet nga agjencitë përkatëse për të kontrolluar nivelin e zhurmave dhe efektin e tyre në shëndetin publik. Në Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, për “Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, neni 7, citohet se njësia bazë e referencës për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e zhurmave është ISHP. ISHP ka kryer monitorimin e zhurmave në mjedis deri në vitin 2014 dhe më pas ka kryer e vazhdon të kryejë matje për subjekte të caktuara sipas ankesave si dhe për subjekte që aplikojnë për leje mjedisi. Shpenzimet operative për monitorimin e cilësisë së mjedisit (pjesë e të cilit është dhe monitorimi i zhurmave), për përpunimin e treguesëve mjedisore, si dhe për kontrollin e saktësisë së tyre, përballohen nga buxheti i MTM-së. Të dy institucionet (AKM dhe ISHP) aktualisht e kanë të paakredituar procesin e monitorimit të zhurmave, gjë që ul besueshmërinë e rezultateve. Akreditimi është një mekanizëm që ndikon në rritjen e besueshmërisë dhe ndihmon autoritetet, ekonominë dhe shoqërinë që të gjykojnë nëse

⁵⁶ http://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0008/136466/e94888.pdf

⁵⁷ Programi Kombëtar i Monitorimit, 2017

laboratorët e provave, organizmat e inspektimit, çertifikimit (Organizma të Vlerësimit të konformitetit) plotësojnë detyrat specifike.⁵⁸ Bazuar në VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” Kreu II, Pika 1, Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton çdo vit Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe e miraton tek Ministri i Turizmit dhe Mjedisit. Në zbatim të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” Kreu IV, Pika 3, si dhe në zbatim të këtij Programi, AKM-ja me të dhënat e siguruar nga monitorimi i mjedisit, përgatit çdo vit Raportin e Gjendjes në Mjedis.⁵⁹ Programi Kombëtar i Monitorimit hartohet mbi bazën e një Sistemi të Integruar të Monitorimit të Mjedisit për të gjithë komponentët: ajrin, zhurmat, ujrat, tokën, pyjet dhe biodiversitetin, si një set stacionesh të monitorimit për çdo komponent, i shoqëruar me një set indikatorësh që duhet të jenë raportuar. Për hartimin e raportit, AKM-ja krahas të dhënave mjedisore, grumbullon edhe të dhëna për nivelin e zhurmave nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, publikimet dhe raportet e dhëna nga burime të tjera. Të dhënat e grumbulluara përpunohen në informacione cilësore mjedisore dhe më pas prezantohen në raport. Këto të dhëna pasqyrohen në formë teksti, tabelash, hartash dhe paraqitjesh grafike.⁶⁰

Fig. 2. Harta e monitorimit të zhurmave për Shqipërinë

Harta e monitorimit të zhurmave, 2017



- 37
- st_Diten
- VI_diten_1
- Prethet

QYTETET	LAEQ/DITEN DB(A)	LAEQ/NATEN DB(A)
Tiranë	66.24	56.12
Fier	52.69	43.51
Vlorë	63.57	49.83
Sarandë	57.19	48.23
Korcë	59.27	44.35
Berat	62.59	50.87
Gjirokastrë	58.35	50.11
Kukës	54.46	41.64
Pogradec	54.58	43.33
Shkodër	62.7	53.57
Standarti OBSH	55	45


Burimi: Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2017

⁵⁸ <http://dpa.gov.al/sq/akreditimi#1>

⁵⁹ Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2017

⁶⁰ Programi Kombëtar i monitorimit, 2017 fq 4.

Fig. 3. Harta e monitorimit të zhurmave për Tiranën



Burimi: Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2017

Në vendin tonë shkaktari kryesor i emetimit të zhurmave është trafiku rrugor. Kjo, sepse sistemi hekurudhor pothuajse nuk ekziston, ndërsa sa i përket sistemit ajror ne kemi vetëm një aeroport ndërkombëtar. Për këtë arsye, AKM kryen monitorimin e zhurmave në trafik rrugor në disa nga qytetet kryesore të vendit tonë. Monitorimi i zhurmave të prodhuara prej trafikut rrugor, është kryer për një kohë matje 24 orëshe. Niveli ekuivalent i presionit akustik LAeq ditën llogaritet nga ora 06⁰⁰- 23⁰⁰ dhe LAeq për periudhën e natës nga ora 23⁰⁰- 06⁰⁰. Matjet e zhurmave bëhen në mungesë të reshjeve, mjegullës dhe borës. Shpejtësia e erës nuk duhet të jetë më e lartë se 5 m/s dhe mikrofoni duhet të jetë i mbrojtur me kufje kundra erës. Zinxhiri i matjeve duhet të jetë në përputhje me kushtet meteorologjike të periudhës në të cilën bëhen matjet dhe në përputhje me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994.⁶¹

Lidhur me monitorimin e zhurmave MTM ka miratuar Udhëzimin nr. 2, datë 07.01.2012 për “Treguesit, mënyrat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike e metodike për vlerësimin e nivelit të zhurmës, si dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e gjendjes”.

Metodologjia e monitorimit të zhurmave sipas praktikës së Serbisë, përcakton matjet në një numër të ndryshëm të vendndodhjeve të pikave të monitorimit dhe në kohë të ndryshme të ditës dhe natës. Numri i pikave të monitorimit varion nga 3 në 40 për zona të ndryshme në të cilat matet zhurma dhe ato janë të përcaktuara në bazë të gjashtë zonave akustike si më poshtë:

- zona rekreative, spitalore dhe rehabilituese, vende kulturore dhe historike, parqe të mëdha;

⁶¹ Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2017, fq 60.

- zona turistike dhe fshatra të vogla, kampe dhe zona shkollore;
- zona banimi;
- zona biznesi, zona tregtare dhe rezidenciale dhe terrene të lojërave;
- qendra e qytetit, zona administrative me ndërtesa, autostrada përgjatë zonës, autostrada dhe rrugët e qytetit;
- zona industriale, depo dhe shërbime dhe terminale të transportit pa ndërtesa banimi⁶².

Zonimi akustik, ose e thënë ndryshe, klasifikimi akustik i territorit, është rezultati i ndarjes së territorit urban në zona akustikisht homogjene. Ai paraqet kuadrin referues për vlerësimin e niveleve të zhurmës egzistuese, apo të parashikuara në territorin në shqyrtim dhe, rrjedhimisht, edhe bazën për programimin e ndërhyrjeve dhe masave të kontrollit apo reduktimit të ndotjes akustike.⁶³

Monitorimi duhet të kryhet me instrumentat përkates, që mund të klasifikohen:

- *Stacion i lëvizshëm*: përbëhet nga aparatura me memorie të mjaftueshme për të dhënat e monitorimit akustik për disa ditë. Këto stacione përdorin mikrofonat për mjedis të jashtëm dhe një sistem ushqyerje autonom (me bateri).
- *Stacion gjysëm fik*: aparatat e përdorura kanë karakteristika analoge me ato të stacionit të lëvizshëm, por ofrojnë edhe mundësinë e pozicionimit në vende të parashikuara për këto qëllime (lidhje me rrjetin elektrik dhe telefonik). Përdoren për monitorime me kohëzgjatje mesatare – të gjatë.
- *Stacion fik*: përbëhet nga një kabinë për mjedis të jashtëm dhe nga aparatura të lidhura në mënyrë permanente me stacionin qendror nëpërmjet linjave telefonike apo radio. Ky stacion kërkon lidhje me rrjetin elektrik si dhe struktura të posaçme instalimi. Përdoret për monitorime me kohëzgjatje të gjatë.⁶⁴

Pikat në të cilat AKM kryen monitorimin e zhurmave mjedisore janë përcaktuar në Programin Kombëtar të Monitorimeve. Për vitin 2018 në Programin Kombëtar të Monitorimeve janë përcaktuar 57 pika monitorimi në territorin e Shqipërisë, 15 nga këto në qytetin e Tiranës. Aparaturat që janë përdorur për kryerjen e monitorimeve janë:

- Pajisje matëse e lëvizshme “Aparati tip Testo 816-1” i cili është i pajisur me kalibrator zëri tip 0554 0452 me anë të të cilit kryhet kontrolli në dy frekuenca, 94 dB dhe 114 dB. Ky aparat (Foto 1 & 2) është në përdorim nga AKM.

⁶² Analysis of systematic measurements of noise in cities, International Conference on Noise and Vibration, 2012, Nis, Serbia.

⁶³ “Studim mbi ndotjen akustike në tiranë dhe mënyrat optimale për reduktimin e saj në ndërtesa”, L. Aleksi, fq. 105.

⁶⁴ “Studim mbi ndotjen akustike në tiranë dhe mënyrat optimale për reduktimin e saj në ndërtesa”, L. Aleksi, fq. 77.

Foto 7. Aparati tip Testo 816-1, (AKM. A. Guri 2019)



Foto 8. Aparati tip Testo 816-1 së bashku me kalibratorin, (AKM. E. Kasmi, 2019)



- Pajisje matëse e lëvizshme “sonometer tip Larson Davis 831” me një korigjim ± 0.35 dB. Kjo pajisje është në përdorim nga ISHP.

Foto 9. Aparati “Sonometer tip Larson Davis 831”, (ISHP. A. Ago 2019)



Foto 10. Aparati “Sonometer tip Larson Davis 831” së bashku me kalibratorin, (ISHP. A. Ago 2019)



Gjetje:

- Procesi i monitorimit dhe matjeve të zhurmave nga AKM dhe ISHP në periudhën 2016-2018, nuk është i akredituar.
- AKM ka kryer monitorimin e zhurmave në kundërshtim me Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 7 dhe VKM nr. 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, Aneksi 1, pika 3, gërma “ë”.
- Frekuenca ose numri i monitorimeve të bëra nga AKM në një vit nuk përfaqëson mesataren e nivelit të zhurmave për pikat e monitorimit.
- Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (PKMM) dhe në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (RGJM) për vitet 2016 dhe 2017 nuk është përshkruar metodika e përzgjedhjes së pikave të monitorimit për qytetet përkatëse.
- RGJM për vitin 2016 ka mospërputhje me PKMM për vitin 2016 lidhur me numrin e pikave të monitorimit.
- RGJM për vitin 2017 ka mospërputhje me PKMM për vitin 2017 lidhur me frekuencën e monitorimit.
- Buxheti i alokuar nga MTM nuk ka mundësuar kryerjen e plotë të monitorimit të zhurmave në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2017.⁶⁵
- Të dhënat për zhurmat që rezultojnë nga matjet vjetore nuk ruhen në arkivin e AKM.

Konkluzione

- Besueshmëria e ulët e raportimit lidhet direkt me mosakreditimin e laboratorëve të monitorimit. Në mungesë të akreditimit të procesit të monitorimit nuk mund të vlerësohet kompetenca dhe plotësimi me efektivitet i detyrave specifike të autoriteteve përgjegjëse. Megjithatë, duhet theksuar se AKM ka nisur procesin e akreditimit të monitorimit të zhurmave duke i kërkuar informacione të hollësishme

⁶⁵ Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2017, fq 61

Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me anë të shkresës me nr. Prot. 2666 datë 17.09.2018.

- Në Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” citohet se njësia bazë e referencës për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e zhurmave është Instituti i Shëndetit Publik. Gjithashtu në VKM nr. 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, Aneksi 1, pika 3, gërma “ë” citohet se institucioni përgjegjës për monitorimin e zhurmave është Instituti i Shëndetit Publik. Pas vitit 2014 dhe konkretisht në vitet 2016-2018 (periudha objekt auditimi) monitorimi i zhurmave është bërë nga AKM duke mos respektuar ligjin dhe VKM-në e sipërcituar.
- Sistemi i monitorimit nuk është gjithëpërfshirës dhe prezantues për të gjetur mesataren e një qyteti të caktuar. Frekuenca ose matja në pikat e monitorimit në vetëm 1 ose 2 ditë në vit nuk mund të nxjerrë rezultate për gjendjen reale të zhurmave gjatë një viti. Për të dalë në këtë konkluzion jemi mbështetur në praktikën zviceriane të përmendur në pyetjen audituese “3.2.1” në të cilën theksohet se frekuenca e monitorimit të zhurmave duhet të jetë disa ditë në stinë.
- Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitet 2016 dhe 2017 nuk përshkruhet mënyra e përzgjedhjes së pikave të monitorimit dhe nuk merren parasysh zonat akustike si në rastin e praktikës së Serbisë. Përzgjedhja e pikave të monitorimit duke marrë në konsideratë të gjashtë zonat akustike ndihmon dhe rrit më shumë vërtetësinë e të dhënave që dalin nga monitorimi i zhurmave për qytetet.
- “Raporti i Gjendjes së Mjedisit”, është dokumenti i përgatitur çdo vit nga AKM, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Në këtë raport paraqiten, komentohen dhe analizohen treguesit mjedisorë (përfshirë edhe zhurmat) si dhe jepen rekomandimet për përmirësimin e gjendjes së tyre. Raportet e Gjendjes së Mjedisit në vitet 2016 dhe 2017 duke qenë se nuk janë në koherencë me Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit, sa i përket kapitullit të monitorimit të zhurmave dhe më specifikisht frekuencës dhe numrit të pikave të monitorimit ka cënuar vlerësimin real të nivelit të zhurmave mjedisore.
- Si rezultat i një buxheti të cunguar nga ana e MTM-së, AKM e ka të pamundur të plotësojë objektivat e saj dhe të Programit Kombëtar të Monitorimit për matjen e zhurmave mjedisore.
- Mos ruajtja e të dhënave në arkiv, nga matjet e kryera në pikat e monitorimit, mund të ndikojë në humbjen e rezultateve dhe gjetjeve nga matjet e kryera gjatë viteve.

Rekomandime

- ISHP të marrë masa për nisjen, ndjekjen dhe përfundimin e procedurës së akreditimit të procesit të monitorimit të zhurmave mjedisore.⁶⁶

Dhjetor 2019

⁶⁶ Afati kohor “Dhjetor 2019” i referohet procedurës së aplikimit për akreditim pasi afati i përfundimit të procedurës së akreditimit varet nga përmbushja e kritereve nga Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit.

- AKM të marrë masa për përfundimin e procedurës së akreditimit të procesit të monitorimit të zhurmave mjedisore.

Qershor 2020

- MTM të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimin e nenit 7 të Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 7 dhe Aneksit 1, pika 3, gërma “ë” të VKM-së nr. 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, me qëllim që procesi i monitorimit kombëtar të zhurmave nga AKM të jetë i ligjshëm.

Dhjetor 2019

- AKM të marrë masat për kryerjen e monitorimit të zhurmave mjedisore disa ditë në stinë.

2020 e në vazhdimësi

- AKM të përzgjedhë pikat monitorimit të zhurmave mjedisore në bazë të gjashtë zonave akustike dhe t'i përshkruajë në PKMM dhe në RGJM.

Për PKMM dhe RGJM të 2020 e në vazhdimësi

- AKM të kryejë monitorimin sipas pikave dhe frekuencës së monitorimit të zhurmave të përcaktuara në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

2020 e në vazhdimësi

- MTM në cilësinë e institucionit përgjegjës të financimit të procesit të monitorimit të mjedisit të alokojë fondet e nevojshme për kryerjen e monitorimit të zhurmave sipas PKMM.

Dhjetor 2019 dhe në vazhdimësi

- AKM të ruajë të dhënat e monitorimit në arkivin e këtij institucioni, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, Neni 26, pika 2.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.3.2 A është efektiv sistemi i inspektimit për subjektet që gjenerojnë zhurmë?

Inspektimi si formë kontrolli organi publik kryen verifikimin dhe respektimin e kërkesave ligjore me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë. Veprimtaria e inspektimit të zhurmave ka për qëllim të vlerësojë respektimin e kërkesave ligjore, dokumentimin e praktikave të mira në respektim të kërkesave ligjore, këshillimin e subjekteve të inspektuara për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore, urdhërimin e korigjimin e shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimin e pasojave që rrjedhin prej tyre. Kompetenca e inspektoriatit përfshin dhënien e dënimeve dhe marrjen e masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë.⁶⁷ Të ardhurat nga gjobat i kalojnë Buxhetit të Shtetit kur

⁶⁷ Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011.

ato janë vendosur nga inspektoriatet qendrore dhe bashkisë kur ato janë vendosur nga struktura përgjegjëse për kontrollin e mjedisit në bashki.⁶⁸

Në vendin tonë institucioni përgjegjës për kryerjen e inspektimit në fushën e mjedisit dhe konkretisht të zhurmave është ISHMPUT. Veprimtaria e punës së tij në lidhje me inspektimin e zhurmave bazohet në Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisje me Leje të Thjeshtë Mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, dhe Udhëzimin nr. 8, datë 27.11.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”. ISHMPUT, si detyrim institucional, miraton programin dhe raportin vjetor të inspektimit dedikuar zhurmave mjedisore. ISHMPUT identifikon subjektet pa leje mjedisore duke ushtruar kontroll, në bashkëpunim me ARM-të dhe AKM-në, për pajisjen e këtyre subjekteve me lejet përkatëse mjedisore.⁶⁹

Në Bashkinë Tiranë, struktura që ka kompetencë kontrolli, është Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit; e cila monitoron, evidenton dhe merr masa ndaj subjekteve tregtare që shkaktojnë zhurma në mjedis në territorin urban. AMK pret ankesa nga qytetarët dhe, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, merr masa në rastet e gjenerimit të zhurmave mbi nivelin e lejuar nga subjekte apo individë.⁷⁰

Gjetje

- ISHMPUT nuk ka një “data base” mbi numrin e subjekteve që operojnë pa leje mjedisore.
- ISHMPUT nuk disponon aparatura matëse të nivelit të zhurmave.
- ISHMPUT gjatë viteve 2016-2018 dhe në vazhdim nuk ka bërë asnjëherë kërkesë për buxhet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me qëllim pajisjen me aparaturat matëse të nivelit të zhurmave.
- ISHMPUT gjatë inspektimit në terren bazohet vetëm në raportet e vetmonitorimeve të zhurmave të kryera nga vetë subjektet.
- ISHMPUT nuk ka një platformë elektronike (wep page) institucionale.

Konkluzione

- Mungesa e një “data base” për subjektet që operojnë pa leje mjedisi ndikon në mos identifikimin e plotë të këtyre subjekteve.
- Mungesa e aparaturave matëse të zhurmave bën të pamundur procesin e inspektimit ndaj tejkalimit të normave të lejuara të zhurmave mjedisore.
- Edhe pse ISHMPUT ka qenë e ndërgjegjshme për mungesën e pajisjeve logjistike, si aparatura matëse të zhurmave, gjatë periudhës 2016-2018 nuk ka kërkuar fonde në Ministri për plotësimin e këtyre mangësive.
- ISHMPUT gjatë inspektimit të subjekteve mjaftohet vetëm me kontrollin e subjekteve nëse ato disponojnë leje mjedisore dhe nëse kanë kryer raportin e vetëmonitorimit.
- Ngritja e platformës elektronike nga ISHMPUT ndihmon në aksesimin sa më të shpejtë të këtij institucioni nga qytetarët, institucionet publike e private si dhe në

⁶⁸ Ligji nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, i ndryshuar; Neni 34, pika 2.

⁶⁹ Rregullore e Brendshme, Nr. 2, datë 18.07.2016, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e ISHMPUT në Nivel Qëndror dhe Rajonal”.

⁷⁰ Vendim Nr. 3183, datë 01.02.2016, “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të AMK, pranë Bashkisë Tiranë”. Neni 23.

informimin e publikut ndaj problematikave mjedisore në tërësi si dhe zhurmave në veçanti.

Rekomandime

- ISHMPUT të bashkëpunojë me Agjencinë e Mbrojtjes së Komsumatorit (Bashkia Tiranë) dhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit me qëllim identifikimin e subjekteve që nuk janë pajisur me leje mjedisore për zhurmat.

Dhjetor 2019 e në vazhdim

- ISHMPUT të bëjë kërkesë për fonde pranë MTM për pajisjen me logjistikën e duhur për kryerjen e matjeve të zhurmave mjedisore.

Shtator 2019

- ISHMPUT gjatë inspektimit në terren të mos bazohet vetëm në raportet vetëmonitorimeve të zhurmave por të kryejë matje në subjekte që supozohen që tejkalojnë vlerat limite të zhurmave.

Dhjetor 2019 e në vazhdim

- ISHMPUT të krijojë një platformë elektronike, me qëllim aksesueshmërinë e saj nga publiku dhe nga institucione të ndryshme.

Menjëherë

3.3.3 A është efektiv sistemi i vetëmonitorimit të subjekteve private që gjenerojnë zhurma në mjedis?

Të gjithë operatorët privatë që gjenerojnë zhurma në mjedis duhet të pajisen me leje mjedisore të tipit C, dhe të kryejnë vetëmonitorimet sipas kushteve të vendosura në lejen mjedisore që i takon subjektit. “Leje mjedisi e tipit C” është leja e miratuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe e lëshuar nga QKL-ja (sot QKB), që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit C, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.⁷¹ Bazuar në Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, vetëmonitorimi i zhurmës në mjedis realizohet nga ekspertë të çertifikuar dhe përballohet nga personat fizikë e juridikë, të cilëve u përkasin veprimtaritë, instalimet dhe burimet e zhurmës që monitorohen. Aktualisht në Shqipëri raportet e vetëmonitorimit për subjektet që zotërojnë leje mjedisore për zhurmat, kryhen nga ekspertë mjedisorë të cilët disponojnë laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Këto vetëmonitorime duhet të dorëzohen në kohën e duhur në ARM-në përkatëse brenda afateve të përcaktuara. Aktualisht, jo të gjithë operatorët i respektojnë afatet e dorëzimit.

Gjetje

- Subjektet që zotërojnë leje mjedisore lidhur me zhurmat nuk i dorëzojnë vetëmonitorimet në kohën e duhur.
- Në Shqipëri nuk ka ekspertë të çertifikuar për zhurmat.

⁷¹ Ligji nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 3, pika 14.

- Të dhënat e vetëmonitorimeve deklarohen gjithnjë brenda normave kombëtare të lejuara.

Konkluzione

- Mosrespektimi i Ligjit nr. 9774, datë datë 12.7.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, Neni 24, pika 3, nga operatorët që zotërojnë leje mjedisore, vjen si pasojë e një bashkëpunimi jo efektiv i ARM-ve dhe ISHMPUT-së.
- Eksperti i çertifikuar bën matje e vlerësime të zhurmës dhe të efekteve të saj. Në mungesë të ekspertëve të zhurmave, vetëmonitorimet kryhen nga ekspertët mjedisorë, të cilët jo të gjithë kanë dije dhe njohuri për zhurmat mjedisore.
- Deklarimi gjithnjë brenda normave të lejuara i të dhënave të vetëmonitorimeve nga subjektet private, bie ndesh me gjendjen reale të zhurmave në zonat urbane dhe me ankesat e shumta drejtuar institucioneve përgjegjëse të kontrollit të zhurmave.

Rekomandime

- ARM-të të bashkëpunojnë me ISHMPUT, me qëllim verifikimin e subjekteve që zotërojnë leje mjedisore dhe që nuk kanë dorëzuar në kohë raportet e vetëmonitorimeve.

Tetor 2019

- MTM të marrë masa për çertifikimin e ekspertëve për zhurmat dhe të ngrejë regjistrin e ekspertëve të çertifikuar të zhurmës në mjedis, të cilat të jenë të hapura për publikun.

Dhjetor 2019

- AKM dhe ISHMPUT të evidentojnë dhe verifikojnë rezultatet e vetëmonitorimeve të subjekteve të pajisur me leje mjedisore për zhurmat.

Nëntor 2019

3.3.4 A është trajnuar stafi i institucioneve përgjegjëse lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore?

Qëllimi i trajnimit të administratës publike është zhvillimi performancës individuale si dhe asaj institucionale. Specialistët dhe punonjësit e ISHP-së, përkatësisht në Sektorin e Fizikës Sanitare, janë të profilit mjek të përgjithshëm dhe fizikantë. Kapacitetet e tyre profesionale janë përshtatur me fushën e përgjegjësive që i takon këtij sektori. Një ndër detyrat e Sektorit të Fizikës Sanitare është përgatitja dhe trajnimi i specialistëve të shëndetit publik në fushën e fizikës sanitare, monitorimin dhe vlerësimin praktikoshkencor.⁷²

ISHP çdo vit kryen trajnime për specialistët duke organizuar seminare 1-2 ditore për specialistët e shëndetit publik të rretheve (të cilët kanë edhe pajisje) dhe njëkohësisht nëpërmjet kurrikulës së trajnimit 3 mujor janë përgatitur specialistët e shëndetit publik të DRSH të Tiranës.

Krahas personelit të ISHP dhe MSHMS të cilët duhet të kenë njohuritë e mjaftueshme gjatë hartimit të politikave lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike dhe efektit që ka

⁷² Rregullore e Brendshme e ISHP, 2014, Neni 24

në shëndetin publik, është shumë e rëndësishme që edhe inspektorët e ISHMPUT dhe punonjësit e AKM të kenë gjithashtu njohuritë e duhura për të kryer inspektime dhe monitorime.

Gjetje

- Stafi i MTM dhe MSHMS nuk kanë marrë pjesë në trajnime lidhur me zhurmat.
- Specialistët e ISHP nuk kanë marrë pjesë në trajnime apo konferenca ndërkombëtare lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike.
- Inspektorët e ISHMPUT nuk kanë marrë pjesë në trajnime ndërkombëtare me fokus zhurmat mjedisore dhe nuk kanë organizuar trajnime zhvilluese për inspektorët rajonal.

Konkluzione

- Mungesa e trajnimeve për stafin e dy ministrive kryesore (MTM dhe MSHMS) në hartimin e politikave lidhur me zhurmat mjedisore ndikon negativisht në cilësinë e këtyre politikave.
- Trajnimet dhe konferencat ndërkombëtare ndihmojnë specialistët e ISHP-së për të fituar njohuri nga praktikat më të mira për kryerjen e studimeve mbi efektet negative shëndetësore që shkaktohen nga zhurmat mjedisore.
- ISHMPUT nuk kanë mundur asnjë trajnim për stafin e tyre gjë që ka çuar në mangësi të theksuara në arritjen e objektivave dhe zbatimin të kriterëve ligjore e rregullatore për një inspektim efektiv dhe të sigurt të zhurmave mjedisore.

Rekomandime

- MSHMS dhe MTM si dy institucionet lider në hartimin e politikave lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike të marrin masa për të trajnuar personelin e tyre përgjegjës.

Janar 2020 e në vazhdimësi

- ISHP të marrë masa për të trajnuar stafin që merret me manaxhimin e zhurmave mjedisore në trajnime dhe konferenca ndërkombëtare.

Janar 2020 e në vazhdimësi

- ISHMPUT të marrë masa për të organizuar trajnime me fokus zhurmat mjedisore, stafin përgjegjës në nivel qendror dhe rajonal.

Janar 2020 e në vazhdimësi

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i auditimit të performancës me temë “Ndotja akustike” krahas evidentimit të kornizës legislative mbi të cilën duhet të përputhet manaxhimi i zhurmave mjedisore ka synuar në vlerësimin situatës aktuale të zhurmave. Ky auditim është fokusuar në nivelin në të cilin janë arritur objektivat e manaxhimit të zhurmave mjedisore nga institucionet përgjegjëse, si dhe në ndikimet që ato japin në shëndetin e popullatës me qëllim përmirësimin aty ku është e mundur të situatës aktuale në tërësi. Kushtet të cilat janë të nevojshme për të siguruar efektivitetin kanë të bëjnë me nivelin e performancës së subjekteve nën auditim. Në këtë auditim jemi përqëndruar në Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit si dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (së bashku me institucionet e tyre në varësi si AKM, ISHMPUT dhe ISHP) si institucionet kryesore në hartimin e politikave lidhur me zhurmat mjedisore. Objektivi kryesor i auditimit ka qenë analizimi i institucioneve përgjegjëse të manaxhimit të zhurmave mjedisore nëse ato kanë vepruar me synimin që t’i garantojnë komunitetit mundësinë e jetesës në mjedise ku garantohet cilësia e shëndetit të qytetarëve dhe zbatohen normat e lejuara për zhurmat.

Masat e marra nga MTM dhe MSHMS si dhe Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore në vendin tonë nuk kanë qenë efektive. Ministria e Turizimit dhe Mjedisit duke mos miratuar një sërë udhëzimesh ka dështuar të plotësojë kuadrin ligjor mbi zhurmat mjedisore me akte nënligjore edhe pse kanë kaluar 12 vite që nga krijimi i ligjit kryesor të zhurmave. Bashkia Tiranë nuk ka hartuar politika të përshtatshme lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore. Plani Vendor i Veprimit të zhurmave, hartëzimi i zhurmave, shpallja e zonave të qeta urbane janë disa nga detyrimet ligjore të cilat Bashkia Tiranë nuk ka arritur t’i përmbushë. Nga ana tjetër, monitorimi i zhurmave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse si pasojë e buxhetit të vogël të alokuar nga MTM, çka evidentohet edhe në mos përmbushjen e objektivave që vetë Ministria e Turizimit dhe Mjedisit vendos. Mosakreditimi i procesit të monitorimit të zhurmave ndikon gjithashtu në besueshmërinë e ulët të të dhënave. Mungesa e aparaturave të matjes së zhurmave në ISHMPUT, sjell vështirësi në inspektim dhe marrjen e masave konkrete kundrejt subjekteve që lëshojnë zhurma sipër normave të lejuara. ISHP nuk ka kryer asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e zhurmave mjedisore në shëndetin e popullatës.

Rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit janë dhënë specifikisht për secilin subjekt të audituar duke theksuar dhe kohën në të cilën duhen përmbushur. Për MTM dhe MSHMS rekomandimet kanë qenë pothuajse të njëjta duke qenë se të dy këto ministri në disa raste kanë mangësi të ngjashme si për shembull në mungesën e sektorëve në organikën e tyre lidhur me zhurmat mjedisore. Një tjetër rekomandim i rëndësishëm për MTM është ai që lidhet me ndryshimin e Ligjit nr. 9774, datë datë 12.7.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, Neni 7, dhe VKM nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” me qëllim që monitorimi i zhurmave që kryhet nga AKM të mbështetet në ligj. Rekomandimet e lëna për AKM lidhen më tepër me përmirësimin e procesit të monitorimit të zhurmave, akreditimin e procesit të monitorimit si një element mjaft i rëndësishëm në rritjen e besueshmërisë së të dhënave të nivelit të zhurmave për pikat e monitorimit. Rekomandimet për ISHMPUT kanë patur më tepër karakter nxitës duke kërkuar që ky inspektoriat të fillojë bashkëpunimin me

institucione të tjera publike si QKB etj., me qëllim identifikimin e subjekteve që operojnë pa leje mjedisi për zhurmat si dhe pajisjen me aparatura për matjen e zhurmave. Rekomandimet për ISHP janë fokusuar më së shumti në kryerjen e studimeve epidemiologjike me qëllim identifikimin e sëmundjeve që shkaktohen nga zhurmat mjedisore.

Rekomandimet kundrejt Bashkisë Tiranë lidhen me hartimin dhe miratimin e Planit Vendor të Veprimit për zhurmat i cili nuk është miratuar deri më sot. Ai hartohet për të manaxhuar problemet dhe pasojat e zhurmës, përfshirë pakësimin e saj deri në nivelin kufi. Hartëzimi i zhurmës si dhe përcaktimi i zonave të qeta janë detyrime të tjera ligjore të cilat nuk janë zbatuar nga Bashkia Tiranë dhe për të cilat grupi i auditimit ka dhënë rekomandime të veçanta. Hartëzimi i zhurmave është paraqitja me indikatorë e të dhënave për zhurmën, për një gjendje ekzistuese ose të parashikuar, që tregon kapërcimin e nivelit kufi, numrin e njerëzve të ndikuar në një zonë të caktuar ose numrin e banesave të ekspozuara ndaj disa vlerave të indikatorit të zhurmës në atë zonë. Hartëzimi i zhurmave realizohet dhe duhet të jetë në sinkron me Planin Vendor të Veprimit për zhurmat


Pyetjet e piramidës	Përgjigja	Struktura përgjegjëse
A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qenë efektive ato?	JO. Institucionet përgjegjëse për hartimin politikave, duke mos miratuar një sërë udhëzimesh kanë dështuar të plotësojnë kuadrin ligjor mbi zhurmat mjedisore me akte nënligjore edhe pse kanë kaluar 12 vite që nga krijimi i ligjit kryesor të zhurmave.	MTM, MSHMS,
A janë hartuar dhe zbatuar politika të përshtatshme nga Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore?	JO. BT nuk ka hartuar politika të përshtatshme lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore. Plani Vendor i Veprimit të zhurmave, hartëzimi i zhurmave, shpallja e zonave të qeta urbane janë disa nga detyrimet ligjore të cilat BT nuk ka arritur t'i përmbushë.	BASHKIA TIRANË
A kanë qenë efektive politikat e ndërmarra nga MSHMS për mbrojtjen e shëndetit publik nga zhurmat mjedisore?	JO. MSHMS edhe pse është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin e politikave lidhur me efektet shëndetësore nga zhurmat mjedisore nuk ka	MSHMS, ISHP
A ka evidenca, raporte apo studime nga institucionet përkatëse mbi efektet negative të zhurmave në shëndetin publik?	JO. Raporti i vetëm në lidhje me zhurmat mjedisore që ISHP ka realizuar është ai i vitit 2014 me temë "Vlerësimi i prevalencës së çrregullimeve të gjumit dhe bezdisjes së popullatës nga zhurmat e trafikut urban, në qytetet kryesore të Shqipërisë". Ky raport i përmend teorikisht barrën e sëmundjes, DALY, etj., por nuk ofron asnjë të dhënë apo përlllogaritje konkrete për rastin e vendit tonë.	ISHP
A është i besueshëm dhe efektiv monitorimi i zhurmave nga AKM dhe ISHP?	JO. Në mungesë të akreditimit dhe të një metodologjie të qartë të procesit të monitorimit nuk mund të vlerësohet kompetenca dhe plotësimi me efektivitet i detyrave të AKM dhe ISHP.	AKM, ISHP
A është efektiv sistemi i inspektimit për subjektet që gjenerojnë zhurmë?	JO. Mungesa e aparaturave matëse të zhurmave bën të pamundur procesin e inspektimit ndaj tejkalimit të normave të lejuara të zhurmave mjedisore.	ISHMPU, AMK (BT)
A është efektiv sistemi i vetëmonitorimit të subjekteve private që gjenerojnë zhurma në mjedis?	JO. Raportet e vetëmonitorimit nuk hartohen nga ekspertë të certifikuar për zhurmat dhe këto raporte nuk kontrollohen nga institucionet përgjegjëse mbi vërtetësinë e tyre.	AKM, ISHMPU
A është trajnuar stafi i institucioneve përgjegjëse lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore?	JO. Mungesa e trajnimeve për stafin e dy ministrive kryesore (MTM dhe MSHMS) dhe institucioneve nën varësi në hartimin e politikave lidhur me zhurmat mjedisore ndikon negativisht në manaxhimin e ndotjes akustike.	MTM, MSHMS, AKM, ISHMPU, ISHP

Aneksi I: PËRGJIGJET E PYETËSORIT “ON LINE” PËR PUBLIKUN LIDHUR ME ZHURMAT MJEDISORE


Grupi i auditimit hartoi një pyetësor për publikun e gjerë, banorë në qytetin e Tiranës, i cili u shpërnda online për një periudhë 20 ditore. Pyetësi u ndërtua me pyetje sipërfaqësore për të parë dhe për të prekur më nga afër problematikat e banorëve lidhur me zhurmat e shkaktuara nga burime të ndryshme në qytetin e Tiranës. Nga ky pyetësor u përfatuan rreth 300 përgjigje, të cilat më pas u përpunuan nga grupi i auditimit. Nga përgjigjet e të anketuarëve “on line” rezultoi se 50% nuk ishin në dijeni mbi institucionin përgjegjës për manaxhimin e zhurmave mjedisore dhe rreth 84% e tyre ishin të prekur nga zhurmat në zonën e banimit përkatës.

Pyetjet:


1. A është e prekur nga zhurmat zona ku ju banoni?




2. Si e vlerësoni qetësinë publike në vendbanimin tuaj?




3. A jeni në gjendje të identifikoni burimin e zhurmave në zonën ku ju banoni?




4. A kanë vepruar institucionet sa i takon ankesave dhe problematikave të komunitetit tuaj lidhur me zhurmat?




5. Në cilin moment efekti i zhurmave ju shqetëson më shumë?




6. A mendoni se zhurmat krahas bezdisjes dhe shqetësimeve mund të bëhen shkaktarë të sëmundjeve të ndryshme shëndetësore?




7. Nëse po, cila nga sëmundjet e mëposhtme ju ka prekur më së shumti?




8. A mendoni se situata në 3-4 vitet e fundit sa i përket zhurmave?



9. A ka vuajtur ndonjë pjesëtar i familjes tuaj nga humbja e dëgjimit? Nëse po shpjegoni nga se ka ardhur?



10. A keni dijeni se cili është institucioni/et përgjegjës për manaxhimin e zhurmave dhe kujt duhet t'i drejtoheni në raste kur shqetësoheni nga zhurmat?



5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE

1. Aulent Guri, Kryeauditues, Përgjegjës i grupit të auditimit;
2. Eva Kasmi, Audituese e Parë, anëtare;
3. Rejlond Sinani, Auditues i Dytë, anëtar.

DREJTOR

Rinald MUÇA